




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



UDHËZUES PRAKTIK PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS

Fusha e kurrikulës MATEMATIKA



Mars, 2014




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



UDHËZUES PRAKTIK PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS

Fusha e kurrikulës MATEMATIKA



Mars, 2014

Përgatitur nga:

Mustafë Kadriu, koordinator i fushës Matematika, MASHT

Ibe Gashi -Demolli, mësime dhënëse - bashkëpunëtore për kurrikula

Koordinuar nga:

Selim Mehmeti, Instituti Pedagogjik i Kosovës

Hajrije Devetaku - Gojani, Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shqipe Gashi, zyrtare për kurrikula në MASHT

Lektor:

Bekim Morina, Instituti Pedagogjik i Kosovës

Botimin e mbështeti:

Zyra për trajnime në MASHT

Dizajni dhe faqosja:

Blendi, Prishtinë

Prishtinë, mars 2014

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	6
1. HYRJE	7
2. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULA BËRTHAMË – ZBATIMI NË PRAKTIKË	9
2.1. Qëllimet e arsimit parauniversitar	9
2.2. Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo- arsimore.....	11
2.3. Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit	15
2.3.1. Rezultatet e të nxënit për shkallë –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre.....	15
2.3.2. Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore.....	18
2.3.3. Rezultatet e të nxënit për klasë, për lëndë mësimore (RNL).....	25
3. ASPEKTET METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT DHE TË ZBATIMIT TË KURRIKULËS SË RE	27
3.1. Plani mësimor	28
3.2. Plani për shkallë kurrikulare.....	29
3.3. Plani vjetor	32
3.4. Plani dymujor	38
3.5. Plani javor.....	44
3.6. Plani i orës mësimore	47
3.7. Çështjet ndërkurrikulare dhe koorrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare.....	49
4. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, MATERIALET MËSIMORE, VLERËSIMI DHE INSTRUMENTET E TIJ	51
4.1. Metodologjia e mësimdhënies në funksion të KKK-së.....	51
4.2. Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre).....	57
4.3. Aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit	59
4.4. Bashkëpunimi i mësimdhënësve, domosdoshmëri për zbatim të kurrikulës së re.....	71
<u>Shtojcat</u>.....	73
Shtojca 1: Disa folje vepruese për hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit...74	
Shtojca 2: Modele të planeve, të përgatitura nga mësimdhënësit	75
Shtojca 3: Pakoja e instrumenteve për planifikimin mësimor	115
<u>Burimet dhe literatura</u>	123

SHKURTESAT

KKK	Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës
KB	Kurrikula Bërthamë
FK	Fushë Kurrikulare
SHK	Shkallë Kurrikulare
RNSH	Rezultatet e të Nxënit për Shkallë Kurrikulare – Kompetenca
RNF	Rezultatet e të Nxënit për Fusha Kurrikulare
RNL	Rezultatet e të Nxënit për Lëndë Mësimore
PV	Plan Vjetor
PD	Plan Ditor
OM	Orë Mësimore
POM	Plani i Orës Mësimore
TM	Teknikë Mësimore
KSH	Kalendari Shkollor
KV	Kalendari Vjetor
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit

1. Hyrje

Krahas hartimit të dokumentit të Kurrikulës së Re të Kosovës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, është me interes që dokumentet të kuptohen dhe të zbatohen praktikisht në procesin mësimor në shkollë. Si domosdoshmëri doli përgatitja e këtij udhëzuesi. Udhëzuesi ofron informata për jetësimin e qëllimeve, për respektimin e parimeve të kurrikulës, kuptimin e zbërthyeshmërisë së kompetencave të të nxëniet dhe rezultatet e fushës kurrikulare, për të lehtësuar bërjen e planifikimeve mësimore të parapara në KKK dhe KB-të sipas niveleve. Udhëzuesi ofron aspekte metodologjike praktike të planifikimit, të mësimdhënies dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në fushën e Matematikës. Ky dokument do t'ju shërbejë mësimdhënësve të arsimit parauniversitar të zotërojnë kompetencat që lidhen me metodologjinë e mësimdhënies, nxënies, vlerësimit, planifikimit, përdorimit të materialeve didaktike mësimore të fushës së Matematikës. Udhëzuesi është i konceptuar në atë mënyrë që të ketë informacione teorike, zbatime praktikë dhe refleksion në punën e realizuar.

1.1 Qëllimi i përgjithshëm i dokumentit

Qëllimi i përgjithshëm i dokumentit është që të jepen informacione për zbatimin e Kurrikulës së Re të Kosovës për fushën e Matematikës, si dhe ngritjen profesionale të mësimdhënësve për të kuptuar dhe zbërthyer KKK, respektivisht zgjerimin e njohurive për planifikimin, metodologjitë e mësimdhënies, krijimin dhe përdorimin e materialeve mësimore dhe për procesin e vlerësimit sipas Kurrikulës për fushën e Matematikës.

1.1 Përdoruesit dhe përdorimi i udhëzuesit

Udhëzuesi për zbatimin praktik të kurrikulës së re të fushës së Matematikës u dedikohet mësimdhënësve të matematikës në SNKA I, SNKA II dhe SNKA III. Udhëzuesi në fillim përdoret si material trajnues i trajnerëve për të zhvilluar më tej aftësitë profesionale të mësimdhënësve në zbatimin e KKK, respektivisht të KB-të për tri nivelet e arsimit parauniversitar. Kurse në të ardhmen llogaritet që ky udhëzues krahas me udhëzuesit për përmirësimin e praktikave në klasë (MASHT & SWAP, 2012), t'ju shërbejë mësimdhënësve gjatë punës së pavarur në realizimin e kurrikulës së re.

1.2 Rezultatet e pritura nga përdorimi i udhëzuesit

Duka pasur parasysh çështjet që trajtohen në udhëzues dhe strategjitë që praktikohen gjatë trajnimit, pritet që mësimdhënësit të arrijnë këto rezultate:

- Të identifikojnë qasjet e arritshmërisë së qëllimeve të arsimit;
- Të identifikojnë qasjet e respektimit të parimeve në procesin arsimor, duke përfshirë planifikimet, metodologjitë dhe vlerësimin;

- Të identifikojnë elementet e domosdoshme të përbërjes së planifikimeve mësimore për zbatueshmëri të KB-ve;
- Të përgatisin modele të planifikimeve mësimore në të cilat përfshihen elementet e domosdoshme të KB-ve;
- Të përgatisin modele të strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit duke respektuar parimet e KKK-së, KB-ve;
- Të përgatisin dhe shfrytëzojnë materialeve të ndryshme mësimore;
- Të zbatojnë strategji, teknika dhe instrumente të vlerësimit konform parimeve të kurrikulës;
- Të zbatojnë strategji të bashkëpunimit kolegjial brenda dhe jashtë shkollës, si kurorëzim i suksesit të shkollës.

1.3 Organizimi i udhëzuesit

Udhëzuesi përbëhet prej katër kapitujve dhe shtojcës. Në secilin kapitull elaborohen çështje të cilat i ndihmojnë mësimdhënësit të kuptojnë ecurinë e zërthimit të KKK-së, respektivisht të KB-ve të të tri niveleve të arsimit parauniversitar në praktikën shkollore dhe t'i bëjnë ata agjentë të ndryshimeve.

Në kapitullin e parë, **Hyrja**, trajtohen rëndësia e udhëzuesit, qëllimi i udhëzuesit, përdorimi dhe përdoruesit e udhëzuesit, rezultatet e pritura nga përdoruesit e udhëzuesit dhe organizimi i udhëzuesit.

Në kapitullin e dytë - **Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikula bërthamë, zbatimi në praktikë**, trajtohen çështje që ndihmojnë jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, respektimin parimeve të kurrikulës në procesin e arsimit në shkollë, kuptimin e zërthyeshmërisë së rezultateve të të nxënit për kompetenca dhe për fusha kurrikulare të shkallëve kurrikulare në planifikime mësimore.

Në Kapitullin e tretë, **Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re**, trajtohen çështje të planifikimeve mësimore, duke integruar elemente të domosdoshme të KB-ve, çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni në mes të fushave kurrikulare.

Në kapitullin e katërt, **Metodologjia e mësimdhënies, materialet mësimore dhe instrumentet e saj**, trajtohen strategji të mësimdhënies dhe të të nxënit, duke përfshirë metoda, teknika të mësimdhënies dhe të të nxënit të suksesshëm, përgatitja dhe shfrytëzim të materialeve mësimore. Trajtohen metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, respektivisht kompetencat, rezultatet e të nxënit dhe nivelet e njohjes në funksion të vlerësimit dhe bashkëpunimi kolegjial në funksion të zbatimit të KB-ve.

Shtojca përmban planifikime dhe materiale të mësimdhënies dhe të vlerësimit, të punuara nga mësimdhënësit.

2. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULA BËRTHAMË – ZBATIMI NË PRAKTIKË

Korniza e Kurrikulës së Kosovës e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës është dokument që rregullon tërë sistemin e arsimit parauniversitar. Ky dokument përcakton:

- Qëllimet e arsimit parauniversitar;
- Parimet kryesore;
- Kompetencat kryesore;
- Nivelet formale, fushat kurrikulare, qasjen në mësimdhënie dhe në vlerësim.

Kurrikulat Bërthamë janë dokumente që në shkollat e Kosovës e bëjnë të zbatueshme Kornizën e Kurrikulës së Kosovës. Këto dokumente janë të veçanta për të tri nivelet e arsimit dhe përcaktojnë rezultatet e kompetencave për lëmi të ndryshme të jetës, të shprehura nëpërmjet njohurive, fakteve dhe procedurave, nëpërmjet të shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave që duhen të zhvillohen te nxënësit gjatë periudhave të caktuara kohore. Po ashtu, këto dokumente përcaktojnë shpërndarjen kohore nëpër fusha kurrikulare dhe ndërlihdjen nëpërmjet tyre, të cilat mundësojnë progresin e zhvillimit të kompetencave.

Pjesë e Kurrikulave Bërthamë është edhe fusha kurrikulare e Matematikës, në të cilën janë përcaktuar: filozofia, konceptet, qasja e bazuar në kompetenca, rezultatet e fushës, ndarja e kohës, udhëzimet metodologjike, udhëzimet për vlerësim, materialet mësimore dhe burimet mësimore.

2.1 Arritshmëria e qëllimeve të arsimit parauniversitar

Qëllimet e arsimit parauniversitar

- Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore;
- Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë;
- Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

Qëllimet e arsimit parauniversitar të paraqitura në KKK (faqe 15) janë pjesë përbërëse e dokumenteve të Kurrikulave Bërthamë të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar. E gjithë përmbajtja e këtyre dokumenteve është në funksion të arritshmërisë së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Kjo do të thotë që edhe rezultatet e të nxënësve për kompetenca, rezultatet e të nxënësve të fushave kurrikulare të secilës shkallë kurrikulare janë në funksion të arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Edhe e gjithë puna praktike edukativo-arsimore që zhvillohet në shkollë duhet të jetë në funksion të arritshmërisë së këtyre qëllimeve. Qasjet e arritjes së qëllimeve duhet t'u përshtaten moshës dhe mundësisë të nxënësve të secilit nivel formal, përkatësisht secilës klasë. Qëllimet e arsimit të parauniversitar arrihen kur ato bëhen pjesë e planifikimeve mësimore (të planifikimeve vjetore, mujore, ditore) dhe e procesit mësimor që zhvillohet në klasë dhe jashtë saj. Pjesë përbërëse e këtij kontributi është edhe fusha e Matematikës. Ajo me gjithë tërësinë e vet organizative, qoftë përmbajtjesore, por edhe praktike (**Kujto mësimdhënien e matematikës!**) kontribuon dhe duhet të kontribuojë në arritjen e këtyre qëllimeve të përbashkëta. Në funksion të arritshmërisë së qëllimeve duhet të jenë edhe këto aktivitete të udhëhequra nga të mësimdhënësit e kuptohet edhe nga mësimdhënësi matematikës, si:

- Përzgjedhja e rezultateve për kompetencë që synohen të arrihen gjatë periudhave të caktuara përmes përmbajtjeve (temave dhe njësive mësimore) dhe aktiviteteve brenda dhe jashtë orës mësimore;
- Përzgjedhja apo adaptimi i rezultateve të fushës, apo lëndës, të secilës klasë nga planet dhe programet ekzistuese që korrespondojnë me rezultatet e të nxënësve të fushave kurrikulare;
- Përzgjedhja e përmbajtjes mësimore (temave apo njësive mësimore);
- Përzgjedhja e metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënësve;
- Përzgjedhja e materialeve dhe burimeve mësimore;
- Përzgjedhja e metodologjive, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit;
- Përzgjedhja e formave të komunikimit;
- Krijimi i klimës në klasë dhe shkollë në favor të arritjes së qëllimeve.

Qëllimet nuk mund të kuptohen si fiksime të veçanta, që arrihen secila ndaras nga njëra-tjetra, ato në shumicën e rasteve funksionojnë si tërësi.

Shembull i angazhimit të arritjes së qëllimeve të arsimit Parauniversitar, shkalla III, KOMPETENCAT, REZULTATET 2.5, 4.7, 6.1, fusha kurrikulare Matematikë, rezultatet 1, 3, 4. Përmbajtja mësimore (tema mësimore): **MATJA E KOHËS**. Qëllimet e synuara mund të jenë **aftësimi për jetë, zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve dhe nëse nxënësit angazhohen p.sh në gjetjen e njësive të matjes së kohës, si dhe zgjidhjen e detyrave që kanë të bëjnë me matjen e kohës në mënyrë individuale a grupore. Promovohet bashkëpunimi si vlerë e përgjithshme kulturore dhe qytetare, rritet përgjegjësia ndaj vetes dhe të tjerëve, rriten angazhimi dhe iniciativa si pjesë të ndërmarrësisë dhe krijohet mundësia për punë të pavarur. Në këtë rast vijnë në shprehje metodologjia e punës, materialet dhe burimet e informacionit, klima pozitive e klasës.**

Aktivitet:

Me kolegë të fushës së Matematikës të klasave të ndryshme të shkallës së njëjtë kurrikulare, analizoni ndonjë rezultat të fushës tuaj kurrikulare (RNF) dhe mundohuni të bëni ndërlidhjen me RNSH-kompetenca dhe me qëllime të arsimit parauniversitar, duke përzgjedhur ndonjë temë, nëntemë apo njësi mësimore konkrete të lëndës së matematikës dhe metoda të mësimdhënies me të cilat do të adresohet arritja e tyre. Diskutoni në fund se përpos qëllimit primar cilat qëllime të tjera synon tema dhe njësia e caktuar.

Burime dhe referenca ju i keni KKK-në, KB-të, planet dhe programet ekzistuese të lëndës së matematikës.

2.1 Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore

Parimet janë një lloj i rregullave, të cilat e mbështesin punën edukativo-arsimore në arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar. (Shih KKK, faqe 31).

PARIMET

- **Gjithëpërfshirja**
 - **Zhvillimi i kompetencave**
 - **Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe koherent**
 - **Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle**
 - **Përgjegjësia dhe llogaridhënia**

Ata janë udhërrëfyes të punës së suksesshme të mësimdhënësve që reflektohen në përgatitjen e nxënësve për sfidat e tanishme në të nxënë dhe në zgjidhje të problemeve në raport me potencialet e tyre dhe në përgatitjen për të nxënë të mëtutjeshëm.

Si mund t'u përmbahemi parimeve?

- ✓ Kur në klasë i pranojmë dhe i presim (me çiltërsi dhe dashuri) njëjtë të gjithë nxënësit pa dallim qoftë të potencialeve, qoftë gjinisë, përkatësisë fetare, përkatësisë sociale, ekonomike, shëndetësore, etnike dhe kulturore;
- ✓ Kur respektojmë te secili nxënës, dinjitetin, përvojat, dijet, stilet e të nxënit dhe mënyrën e të shprehurit.

Atëherë jemi në linjë të parimit të gjithëpërfshirjes, sepse:

- kemi dëgjuar me kujdes mendimin e nxënësit-ses
- kemi planifikuar duke diagnostikuar përvojat, dijet, kulturat stilet e të nxënit të nxënësit-es dhe kemi përmirësuar mësimdhënien,
- kemi planifikuar duke synuar,
- kemi përdorur llojllojshmëri të metodave, teknikave dhe materiale të ndryshme të mësimdhënies dhe të të nxënit, detyra të diferencuara për realizim të aktivitetit.

Dhe

Nxënësi-ja e ka gjetur veten diku dhe i ka arritur kërkesat e shtruara, sepse kem krijuar klimë ku secili-la ndihet rehat, i-e çmuar, kontribuues-e dhe i e suksesshëm-e. Në këtë mënyrë është bërë pjesë e aktivitetit të të nxënit.

GJ
I
TH
Ë
P
Ë
R
F
SH
I
R
J
A

- ✓ Kur nxënësi-ja identifikon, krahason, analizon dhe vlerëson, ngjarje dukuri dhe zgjidh problema konform rezultateve të të nxënit të fushës së matematikës sipas shkallës - klasës;
- ✓ Kur nxënësi-sja demonstroi shkathtësi të komunikimit (dëgjon dhe është konstruktiv në dhënien e mendimeve qoftë verbalisht apo me shkrim), të menaxhimit të detyrës, aktivitet, kohës dhe mjeteve, shfrytëzimit të burimeve...;
- ✓ Kur te nxënësi-ja zhvillon vlera si, tolerancën, mirësjelljen, solidaritetin-përkrahjen, respektin dhe përgjegjësin ndaj vetes, të tjerëve dhe mjedisit;
- ✓ Kur nxënësi-ja menaxhon emocionet e veta, nuk është arrogant-e, konfliktuoz-e, i-e tensionuar... .

Atëherë jemi në linjë të arritjes së kompetencave, sepse:

- Kemi planifikuar duke pasur parasysh rezultatet e të nxënit të shkallës (kompetencës), fushës së Matematikës të marra dhe të adaptuara nga planet dhe programet ekzistuese, e nëse e jo i kemi hartuar vetë;
- Kemi aplikuar metodologji dhe mjete didaktike të cilat kanë nxitur dëshirë, kreativitet dhe pavarësi te nxënësit-et;
- Kemi përdorur teknika dhe instrumente të vlerësimit të cilat kanë ndihmuar vetëvlerësimin, identifikimin e saktë të shkallës së arritshmërisë dhe pastaj marrjen e masave për përmirësim.

Kështu zhvillojmë nxënës-se kompetent-te

ZH
V
I
LL
I
M
I

I

K
O
M
P
E
T
E
N
C
A
V
E

Mësimdhënia dhe të nxëniti e integruar dhe koherent

- ✓ Kur nxënësi-ja analizon një detyrë, situatë, ngjarje a dukuri në kënde të ndryshme (p.sh të një lloj ushqimi sheh përbërjen, përdorimin, dhe vendin e prodhimit –këtu ka elemente shkencave të natyrës, jetës dhe punës, por edhe të gjeografisë; p.sh. trupat gjeometrikë, kur flasin për formë mendojmë në matematikë, shkenca të natyrës, arte etj).
- ✓ Kur nxënësi-sja identifikon ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e detyrave, ngjarjeve dhe dukurive (p.sh. veprimet me numra i përdor në problema nga jeta e përditshme dhe në lidhshmëri me fushat e tjera kurrikulare).

Atëherë jemi në linjë të mësimdhënies dhe të të nxëniti koherent

- Kemi planifikuar lidhje në mes të fushave kurrikulare ashtu që kemi zhvilluar matematikën te shkencat, artet, jeta dhe puna.
- Kemi planifikuar module dhe projekte, ku gjenden elemente të fushave kurrikulare, p.sh. projekti Mbjellja e luleve në një kënd të oborrit të shkollë-atëherë kanë ardhur në shprehje shkencat natyrore duke e studiuar kohën e përshtatshme për mbjellje...,matematika duke matur sipërfaqen ku duhet mbjellë lulet, duke ditur rëndësinë ruajtjes dhe krijimit të një mjedisi të këndshëm, shëndeti dhe mirëqenia, artet etj.

Kështu kemi krijuar të nxënë të qëndrueshëm dhe koherentë

Autonomia dhe fleksibiliteti

- ✓ Kur nxënësi-ja nxë në bazë të ritmeve dhe stileve individuale të nxëniti
- ✓ Kur nxënësi-ja zhvillon, talentin, nxë mbi bazën e afinitete dhe interesave
Atëherë jemi autonomë dhe fleksibil.
- Kemi përgatitur planifikime mësimore (vjetore, dymujore, ditore) konform rezultateve të të nxëniti për shkallë-klasë, rezultateve të të nxëniti për fushë kurrikulare dhe konform përvojave, ritmeve e stileve të të nxëniti të nxënësve të cilët-at i udhëhiqemi.

Kështu kemi zhvilluar nxënës-e të suksesshëm-e

Përgjegjësi dhe llogaridhënia

- ✓ Kur nxënësi-ja di për nivelin e rritjes së vetë konform kërkesave të shtruar nga mësimdhënësi;
- ✓ Kur prindërit e dinë nivelin e arritjes së fëmijëve të tyre konform rezultateve të nxënimit të shkallës (kompetencës) rezultateve të të nxënimit të fushës kurrikulare dhe lëndës mësimore për shkallë, klasë a temë mësimore;
- ✓ Kur këshilli i klasës, Këshilli i shkollës e dinë nivelin e rritjes së nxënësve të paraleles

Atëherë jemi përgjegjës-se dhe llogaridhënës-se, sepse:

- ✓ jemi transparentë për saktësinë dhe nivelin e arritjes së kompetencave dhe rezultateve për secilën detyrë, aktivitet;
- ✓ jemi transparentë dhe në komunikim të vazhdueshëm me prindër për të arriturat rezultateve të kompetencave dhe rezultateve të fushës a temës mësimore;
- ✓ jemi transparentë me Këshillin e klasës, shkollës për nivelin e arritjes së rezultateve të kompetencave, fushave, lëndës a temës për paralelet të cilat i udhëheqim.

AKTIVITET: Diskutoni me kolegët e fushës tuaj se si mund të zbatohen/respektohen parimet në kuadër të lëndës së matematikës. Merrni ndonjë shembull.

Lënda: _____

Klasa: _____

Tema: _____ **Njësia mësimore** _____ **RNSH** _____

RNF _____

Parimet që respektohen gjatë procesit të përgatitjes dhe realizimit:

2.3 Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit

Rezultatet e të nxënit

- *Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetencë) dhe arritshmëria e tyre;*
- *Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare dhe përmbajta mësimore;*
- *Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore, brenda shkallës kurrikulare.*

2.3.1 Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare/kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre

Sipas KKK-së, të mësuarit është i bazuar në këto kompetenca (Shih KKK faqe 17):

• Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit (Komunikues efektiv)
• Kompetenca e të menduarit (Mendimtar kreativ)
• Kompetenca e të mësuarit (Nxënës i suksesshëm)
• Kompetenca që ka të bëjë me jetën dhe punën (Kontribuues produktiv)
• Kompetenca personale (Individ i shëndosh)
• Kompetenca shëndetësore (Qytetar i përgjegjshëm)

Organizimi i mësimit përqendrohet në zhvillimin e këtyre kompetencave, në atë që duhet të dinë të bëjnë nxënësit dhe që duhet të jenë të gatshëm të bëjnë. Për të bërë diçka duhen njohuritë, shprehitë, shkathtësitë përkatëse, por edhe qëndrime të caktuara. Bazuar në këtë, Kurrikula e Matematikës është e konceptuar në një sistem të ndërtuar me bazë nivel, shkallë dhe klase. Përshkrimi i nivelit ofron bazat e marrjes së vendimeve për performancën e nxënësve në fund të çdo shkalle kryesore, 1- 6.

Rezultatet e të nxënit për shkallë – kompetencat (RNSH) janë kërkesa që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në fund të secilës shkallë. Ato janë njohuri, shkathtësi, qëndrime, vlera dhe rutina, të cilat duhet zhvilluar te secili nxënës-e përgjatë klasave sa ka shkalla kurrikulare.

Si zhvillohen (arrihen) kompetencat?

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht arritshmëria e rezultateve të tyre, bëhet përmes fushave kurrikulare. Të gjitha fushat kurrikulare duhet të kontribuojnë bashkërisht në arrijtjen e rezultateve të kompetencave të shkallës. Nuk do të thotë që domosdoshmërisht secila fushë kurrikulare si e vetme të arrijë të gjitha rezultatet e të gjitha kompetencave, por secila fushë kurrikulare duhet fiksojë rezultatet e të nxënit për kompetencat që do të synojë

t'i arrijë për secilën klasë. Pra, do të thotë që edhe fusha, respektivisht lënda e matematikës, duhet bërë fiksimin e RNSH-ve që synon t'i arrijë. Mund të ndodhë që disa rezultate të njëjta të kompetencave të jenë pika synuese për disa fusha kurrikulare, por mund të ndodhë që disa të përzgjidhen nga një fushë e vetme kurrikulare.

P.sh. rezultati IV.4 (KB shkalla e tretë, f. 21), nxënësi-sja “Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj)” është rezultat që arrihet përmes të gjitha fushave kurrikulare.

POR KUJDES! Të gjitha rezultatet e kompetencave duhet të arrihen deri në fund të shkallës së caktuar dhe gjithsesi duhet të koordinoheni me fushat e tjera kurrikulare.

Rezultate e të nxënit për shkallë (kompetencat) dhe rezultatet e fushës për shkallë mund të jenë të synuara në çdo klasë sa ka shkalla, por arritshmëria e tyre duhet të bëhet konform moshës dhe mundësive të nxënësve. P.sh. rezultatet e mëposhtme mund të synohen në klasat VI dhe VII, por arritshmëria e plotë e tyre duhet të bëhet deri në fund të klasës së gjashtë.

Hapi 1	hapi 2
RNSH (kompetenca) SHK. 3	RNF SHK. 3
2. KOMPETENCA E TË MENDUARIT (MENDIMTAR KREATIV) SHK. 3 2.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjet e përfundimit domethënë rezultatin e njëjtë.	1. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE Përdor simbole, fakte, mjete dhe strategji adekuate për zgjidhje të problemeve që kanë të bëjnë me numra racionalë, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe matjen e formave 2D dhe 3D.

Vëmendje! Jo vetëm kjo renditje logjike e rezultateve të marra nga KB të shkallës së caktuar e ndihmon arritjen graduale të tyre nga nxënësit, por edhe vetë rezultati mund të zbërthehet nëpër klasë brenda shkallës së caktuar në vështirësi të ndryshme. *Shembull te rezultati 2.5 në fillim nxënësit mund t'i fokusojmë në identifikimin e disa ecurive të ndryshme për zgjidhjen e një problemi, por më vonë demonstrojnë ecuri e strategji të ndryshme dhe adekuate në zgjidhjen e problemeve matematikore.*

Aktiviteti 1: Diskutoni me kolegët tuaj se cilat rezultate të të nxënit të kompetencave (RNSH) do të synoni t'i arrini përmes matematikës dhe më pas këtë përzgjedhje diskutoheni me kolegët e fushave të tjera kurrikulare që japin mësim në shkallë e njëjtë me ju.

Aktiviteti 2: Më pas, rezultatet e përzgjedhura diskutoni se si do t'i arrini nëpër klasë, disa në një klasë e disa në klasën tjetër, apo do t'i synoni të gjitha në të gjitha klasat sa ka shkalla e caktuar kurrikulare, por t'i zbërtheni në secilën klasë.

2.3.2 Rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore

RNF-të janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme të fushës së kurrikulës (Matematika) dhe janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore.

Konceptet janë shtylla përmbajtjesore rreth së cilave organizohet e gjithë përmbajtja mësimore e fushës kurrikulare brenda shkallës kurrikulare. Ato janë të pranishme në klasat e shkallës kurrikulare. Fuqia e prezencës së tyre në periudha të ndryshme kohore brenda një viti shkollor të një klasë të caktuar, por edhe të klasave të ndryshme të shkallës së njëjtë, mund të jetë e larmishme. Në fushën e Matematikës kryesisht mund hasni këto **koncepte**:

- numri dhe algjebra;
- forma, hapësira, matjet dhe gjeometria;
- përpunimi dhe shënimeve dhe probabiliteti;
- përdorimi dhe zbatimi i matematikës.

Mësimi i matematikës për nivele - shkallë kurrikulare dhe veç e veç për klasë kompozohet rreth komponentëve kryesorë të tij:

1. Zgjidhja e problemeve
2. Arsyetimi matematik
3. Lidhjet në matematikë
4. Përfaqësimi matematik
5. Modelimi matematik
6. Të menduarit matematik
7. Përdorimi i teknologjisë në matematikë

Kur t'i bëjmë një analizë Kurrikulës Bërthamë /Kurrikulës së Matematikës shohim se rezultatet e fushës (RNF) janë kompozuar mbi bazën e këtyre komponentëve.

Cili është funksioni i komponentëve mësimorë të nxënësve të matematikës, respektivisht të RNF-ve?

(Këta komponentë njihen edhe me emërtimin kompetencat matematikore)

- **Zgjidhja e problemeve matematikore**

Zgjidhja e problemeve është një proces që zhvillon njohuritë e nxënësve në matematikë përmes detyrave që rezultati dhe procedura e zgjidhjes nuk janë të njohura më parë.

Përmes zgjidhjes së problemeve nxënësit kuptojnë ndjenjën e fuqisë së matematikës që e rrethon. Zgjidhja e problemeve është pjesë konsistence e secilës pjesë të fushës së Matematikës. Nxënësve u mundësohet për të:

- ✓ Ndërtuar njohuri të reja përmes zgjidhjes së problemeve;
- ✓ Zgjidh problemet që janë nga fusha e Matematikës dhe në kontekste të tjera;
- ✓ Zbatuar dhe përshtatur një shumëllojshmëri të strategjive për të zgjidhur problemet;
- ✓ Monitoruar dhe reflektuar në procesin e zgjidhjes së problemeve.

Shih **shembullin** e zëbrthimit të rezultatit të nxënësve të fushës së Matematikës (RNF) në detyrë, aktivitet mësimor që në fokus e ka zgjidhjen e problemeve matematikore.

Microsoft PowerPoint - [2 Mustafa- Kurikuli]

File Edit View Insert Format Tools Slide Show Window Help

Type a question for help

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE MATEMATIKE

Shkalla 3. ,RNF 1, Nxënësi: **Përdor simbole, fakte, mjete dhe strategji adekuate për zgjidhje të problemeve që kanë të bëjnë me numra racionalë, marrëdhëniet mes tyre si dhe matjen e formave 2D dhe 3D.**

Dëshmia: *Nxënësi mundë të zbaton një strategji për të interpretuar dhe vërtetuar një zgjidhje matematikore për problemin.*

1. Në një dhomë të mbyllur ndodhen 5 arka, e në secilën arkë ndodhen nga tre kuti metalike dhe në secilën kuti gjenden nga 10 monedha ani. Të gjitha janë të mbyllura me çelësa të ndryshëm, dhoma, arkat dhe kutitë. Sa çelësa më së paku nevojiten që të mund të marrim 70 monedha ani?

A. 10
B. 11 *
C. 12
D. 13

Click to add notes

Slide 17 of 34 Office Theme

- **Arsyetimi dhe dëshmitë matematike**

Arsyetimi dhe dëshmitë janë procese që zhvillojnë aftësitë e nxënësve në matematikë, duke përdorë konjunkturën matematike, nxjerrje e konkluzioneve logjike, hipoteza dhe të menduarit të tyre kritik, justifikim idesh, analizim të provave dhe ndërtim argumentesh.

Arsyetimi është themelor në mësimin e matematikës. Pavarësia e çdo individi zhvillohet nëpërmjet ndërgjegjësimit të tij për të arsyetuar në mënyrë logjike dhe për të argumentuar mendimin e tij. Gjatë zgjidhjes problemave, nxënësit aftësohen për të parashtruar argument bindëse, e për të vlerësuar argumentet e paraqitura nga të tjerët. Klasifikimi, argumentimi logjik, të menduarit induktiv dhe analogjia janë pjesë e rëndësishme e zbatimit të programit nëpër klasa. Zhvillimi i aftësisë për të gjykuar në mënyrë logjike është i lidhur me zhvillimin intelektual dhe verbal të nxënësit.

Nxënësve u mundësohet për të:

- ✓ Njohur arsyetimin dhe provat si aspekte themelore matematikore;
- ✓ Bërë dhe hetuar konjunkturën matematikore;
- ✓ Zhvilluar dhe vlerësuar argumentet matematikore dhe provat;
- ✓ Zgjedhur dhe përdorur lloje të ndryshme të arsyetimit dhe metodat e provës.

- **Komunikimi matematik**

Komunikimi matematikor është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t'i shprehur idetë matematike me rrjedhje logjike, që i justifikon ato në audiencë dhe në shoqëri përmes të folurit dhe të shkruarit për atë që e bëjnë me simbole, terme, grafike, modeleve dhe shprehjeve matematikore. Matematika është një gjuhë, e cila merr kuptim te nxënësit nëse ata fillojnë të komunikojnë (me shkrim ose me gojë) konceptet matematike dhe të zbatojnë njohuritë matematike në mënyrë të frytshme. Nxitja e nxënësve për të përshkruar situata, zgjidhje, vrojtime, hulumtime, për të plotësuar ose interpretuar tabela, diagrame, ndikon pozitivisht në zhvillimin e shprehive komunikuese. Zhvillimi i aftësisë për të arsyetuar në mënyrë abstrakte shoqërohet me zhvillimin e aftësisë për të komunikuar matematikisht.

Nxënësve iu mundësohet për të:

- ✓ Organizuar dhe konsoliduar të menduarit e tyre matematikore përmes komunikimit;
- ✓ Komunikuar të menduarit e tyre matematik koherent dhe të qartë për audiencë;
- ✓ Analizuar dhe vlerësuar të menduarit matematik dhe strategjitë e të tjerëve;
- ✓ Përdorur saktësisht gjuhën e matematikës për të shprehur idetë matematikore.

- **Lidhjet në matematikë**

Lidhja matematike është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t'i lidhë idetë dhe njohuritë matematike, brenda fushës së matematikës dhe jashtë saj. Gjatë mësimit të matematikës nxënësit kanë nevojë të kuptojnë që konceptet matematike lidhen me njëri-tjetrin, me lëndët e tjera dhe me situata të jetës së përditshme. Për këtë qëllim, përmbajtjet nuk duhen trajtuar të izoluara, por të ndërthurura me njëra-tjetrën për të dhënë idenë e matematikës si një e tërë. Tërësia e matematikës ka të bëjë me përdorimin e koncepteve të njëjës përmbajtje për të dhënë koncepte të përmbajtjes të tjera, si dhe në përdorimin e shprehive të ndërsjella (p.sh. të shprehive algjebrike për të zgjidhur problema gjeometrike). Përdorimi bindës i matematikës në shtjellimet brenda fushave dhe në ato të fushave të tjera dhe anasjellas, si dhe marrja e zbatimeve nga situata reale i ndihmon nxënësit të zbulojnë rolin e matematikës në një kontekst më të gjerë, ta konsiderojnë matematikën si një mjet të fuqishëm e të larmishëm për të kuptuar e për të ndikuar në botën që i rrethon.

Nxënësve u mundësohet për të:

- ✓ Njohur dhe të përdorur lidhjet e ideve matematikore;
- ✓ Kuptuar se si idetë matematikore ndërtohen njëra mbi tjetrën dhe për të prodhuar një tërësi koherente;
- ✓ Zbatuar matematikën në kontekste brenda dhe jashtë fushës së matematikës.

- **Përfaqësimi matematik**

Përfaqësimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të përfaqësuar objektet matematikore dhe veprimeve, duke përfshirë numra, forma dhe relacione. Përfaqëson dhe analizon situatat dhe strukturat matematikore.

Nxënësve u mundësohet për të:

- ✓ Krijuar dhe përdorur përfaqësitë për të organizuar, regjistruar dhe komunikuar idetë matematikore;
- ✓ Zgjidhur, përkthyer dhe zbatuar përfaqësimet që kanë të bëjnë me zgjidhje probleme matematikore;
- ✓ Përdorur përfaqësime për modele dhe interpretime të fenomeneve, sociale natyrore dhe matematikore.

- **Modelimi matematik**

Modelimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të kuptuar format, modelet në kontekste të ndryshme. Relacionet dhe funksionet, paraqitjen dhe analizimin e strukturave matematikore.

Nxënësve u mundësohet për të:

- ✓ Krijuar dhe përdorur modelet të ndryshme;
- ✓ Paraqitur modelet dhe rolin e tyre në kontekst;
- ✓ Përdorur modelet për të përfaqësuar dhe për të kuptuar relacionet sasiore;

- ✓ Interpretuar me modele fenomenet, sociale natyrore dhe matematikore.

Shih **shembullin** e zbërthimit të rezultatit të të nxënimit të fushës së Matematikës (RNF) në detyrë, aktivitetet mësimor që në fokus e ka modelimin matematik.

MODELIMI MATEMATIK


Shkalla 4 rezultatit (RNF) 6, nxënësi: Përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të përditshme (p.sh. ekonomisë familjare, statistika elementare për jetë etj.) që lidhen me numra, format 2D dhe objektet 3D.

Dëshmia: Nxënësi mund të interpretoj një situatë në mënyrë matematikore në raport me situatën e krijuar.

Shembull. Në figurën e dhënë, katrorët janë renditur sipas një rregulle

a) Sa katror do të jenë në figurën e radhës?

- A. 17
- B. 19
- C. 21
- D. 23



b) Sa katror do të jenë në figurën e 9-të të radhës?

Rez.37

c) Cila shprehje shkronjore përcakton renditjen e katrorëve sipas rregullit?

Rez. $4n+1$

• Të menduarit matematik

Të menduarit matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të parashtruar pyetjet dhe pritjet nga përgjigjet e mundshme.

Nxënësve u mundësohet:

- ✓ Për të ndërgjegjësuar për llojet e pyetjeve që e karakterizojnë matematikën;
- ✓ Aftësia për të parashtruar pyetje dhe llojet e përgjigjeve të pritshme të mundshme.

• Përdorimi i teknologjisë në matematikë

Përdorimi i teknologjinë është një proces që zhvillon njohuritë dhe aftësitë e nxënësve për të përmbushur në mënyrë rigoroz kompetencat në matematikë dhe t'i bëjë të suksesshëm edhe përtej shkollës.

Nxënësve u mundësohet për të:

- ✓ Bërë përdorimin e mjeteve dhe teknologjisë informative;
- ✓ Njohur dhe përdorur programet informative, përparësitë dhe kufizimet e tyre.

Rezultatet e fushës së matematikës përmbushën nëpërmjet:

NJOHURIVE MATEMATIKE:

Njohuritë matematike janë tërësitë e informacioneve që zotërohen nga ana e nxënësit, e që kanë të bëjnë me: Terminologjinë dhe simbolet, përkufizimet e koncepteve, faktet matematike (aksiomat, teoremat, rregullat, formulat), metodat matematike (të njehsimit, zgjidhjes, ndërtimit, vërtetimit).

AFTËSIVE MATEMATIKE:

Aftësitë matematike janë fuqia dhe cilësia që zotëron një nxënës për të përmbushur një veprim në mënyrë të suksesshme brenda një afati të caktuar kohor, e që kanë të bëjnë me: Identifikim, përshkrim, formulim, arsyetim, vërtetim, zbatim, analizën, sintezën, hipotezën, vlerësimin.

SHKATHTËSIVE DHE SHPREHIVE MATEMATIKE:

Shkathtësitë tregojnë mënyrën e të menduarit, të punuarit, të komunikuarit, të lidhjes, të cilat nxënësit duhet t'i zotërojnë dhe t'i përdorë në situata të ndryshme për të kryer: Njehsime, matje, ndërtime, skicime, zgjidhje, përdorim burimesh, përdorim informacionesh, përdorim të teknologjisë, lexim të modeleve numerike, lexim të modeleve hapësinore, krijim të modeleve numerike, krijim të modeleve hapësinore.

QËNDRIMEVE DHE VLERAVE:

Qëndrimet dhe vlerat tregojnë mënyrën e sjelljes së nxënësve gjatë kryerjes së veprimtarive në procesin mësimor: Pjesëmarrje në diskutim, bashkëpunim, kërkim ndihme, dhënie ndihme, verifikim, respektim mendimi i tjetrit/rës, marrje e përgjegjësisë, vëmendje, demonstrim vullneti, respektim i rregullave, përmbushje e detyrave.

Si e përzgjedhim përmbajtjen nga RNF?

Me rastin e përzgjedhjes së rezultateve të të nxënit të fushës, të cilat synojmë t'i arrijmë me nxënës në klasë të caktuara, së pari duhet identifikuar konceptet e fushës kurrikulare nga të cilat dalin rezultatet e caktuara të fushës kurrikulare. Ndosht që disa koncepte të fushës kurrikulare të jenë prezente në një rezultat të fushës kurrikulare, por sidoqoftë njëra nga to ndihet më fuqishëm.

Konceptet e fushës kurrikulare së bashku me rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare na ndihmojnë në përzgjedhjen e përmbajtjes mësimore (temave mësimore) për fushën kurrikulare për secilën klasë sa ka shkalla kurrikulare.

Temat mësimore janë tërësi mësimore, të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë fushën kurrikulare gjatë periudhave të caktuara kohore të një viti shkollor.

Hapi 1	hapi 2	hapi 3
Konceptet Numri dhe algjebra	RNF, Shkalla 3 1. Përdor simbole, fakte, mjete dhe strategji adekuate për zgjidhje të problemeve që kanë të bëjnë me numra racionalë, marrëdhëniet mes tyre, si dhe matjen e formave 2D dhe 3D.	Tema mësimore 1. Numrat (natyrorë, thyesor dhe dhjetorë). 2. Bashkësitë (veprimet me bashkësi dhe pasqyrimi).

Vëmendje! Me këtë koncept mund të korrespondojnë disa rezultate të të nxënit të fushës së Matematikës (RNF). Gjithashtu, nga një RNF mund të dalin disa tema mësimore.

Aktivitet

Aktiviteti 1: Zgjidheni ndonjë rezultat të të nxënit të shkallës (RNSH) në një nga gjashtë kompetencat. Bisedoni në grup se cilat nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) kontribuojnë në arritjen e RNSH-së që këni zgjedhur. Po ashtu bisedoni me çfarë teme apo temash mësimore do të mund të adresohet ai rezultat konkret. Diskutoni zgjedhjet tuaja me kolegë të matematikës.

Aktiviteti 2: Me kolegë të fushës së matematikës identifikoni se cilat RNF korrespondojnë me konceptet e fushës së matematikës. Më pas diskutoni se cilave koncepte dhe RNF do t'ju jepni prioritet në secilën klasë brenda shkallës së caktuar.

Aktiviteti 3: Identifiko ndonjë RNF të njërës kompetencë (komponentë) të fushës së matematikës, cakto dëshminë për këtë rezultat dhe në fund cakto një aktivitetet (detyrë) që është në funksion të arritjes së rezultatit të synuar.

2.3.3 Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare, apo lëndës mësimore (RNL) brenda shkallës kurrikulare

Meqenëse rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare në kurrikulat bërthamë paraqiten për shkallë e jo për klasë mësimore, atëherë konsiderohet si nevojë hartimi i rezultateve të të nxënit për klasë brenda një shkalle kurrikulare, respektivisht lëndë mësimore, sepse sigurohet kohezioni dhe mosngarkesa e njëjës klasë brenda një shkalle kurrikulare.

Si hartohen rezultatet për klasë?

Hartimi i rezultateve të të nxënit për klasat e caktuara mund të bëhet nga vetë mësimmshënësit, por edhe të merren nga planet dhe programet ekzistuese. Nëse shfrytëzohen planet dhe programet ekzistuese, atëherë shkrimi i tyre bëhet duke i krahasuar rezultat e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e të nxënit të fushës së Matematikës në kurrikulat bërthamë. Në këtë rast bëhet përzgjedhja e rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese që janë në funksion të arritjes të secilit rezultat të të nxënit të fushës të Kurrikulës Bërthamë. Nëse rezultatet e pritshme të përzgjedhura nga planet dhe programet nuk përmbushin në tërësi rezultatin e caktuar të fushës kurrikulare, atëherë mund të shkruhen edhe rezultate të reja. Rezultat e fushës kurrikulare apo lëndës mësimore për klasë mësimore na ndihmojnë në përcaktimin e njësive mësimore, të cilat janë në funksion të temës së përbashkët të fushës kurrikulare.

Rezultatet e të nxënit janë deklarata, të cilat duhet të realizohen në mënyrë të strukturuar. Struktura e rezultatit të të nxënit për lëndë përmban katër pjesë kryesore: Aktiviteti (A), Objekti (O), Kushtet (K) dhe Kriteri (K).

Shembull jo drejtë i shkrimit të rezultatit

Nxënësi:

- *Të dijë (aktiviteti) të modelojë rrjetën e kubit (objektit) në fletore (kushti).*

Shembull i drejtë i shkrimit të rezultatit

Nxënësi:

- *Modelon (aktiviteti) rrjetën e kubit (objekti) në fletore (kushti).*

- *Përdor (aktiviteti) saktësisht (kriteri) Teoremën e Pitagorës (Objekti) për të gjetur gjatësinë e diagonales së një katrori kur dihet brinja e tij (kushti).*

Shih formatin e mundshëm të tabelës të hartimit të rezultateve për fushë apo lëndë mësimore në nivel klase. Ky format duhet të zhvillohet sipas hapave të dhënë në tabelë.

Krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës së Kurrikulës Bërthamë (KB), Shkalla 3							
Fusha e matematikës							
Rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Matematikë i marrë nga KB	Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF të KB-ve.			Rezultatet e pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore.		Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL)	
	Lënda	Klasat		Klasat		Klasat	
		E gjashtë	E shtatë	E gjashtë	E shtatë	E gjashtë	E shtatë
Nxënësi/ja:	Nxënësi/ja:	Nxënësi/ja:	Nxënësi/ja:	Nxënësi/ja:	Nxënësi/ja:	Nxënësi/ja:	Nxënësi/ja:

Për çështje praktike, rezultateve të fushës së kurrikulës (RNF) marr nga Kurrikula Bërthamë, por edhe rezultateve të planeve dhe programeve ekzistuese, është mirë që t'u vendoset nga një numër rendor, kur vendosen në këtë tabelë, në mënyrë që të dihet saktë se cilat rezultate korrespondojnë me njëra-tjetrën. Nëse njërit rezultat të fushës kurrikulare në nivel shkalle i keni vendosur numrin rendor 1, atëherë edhe rezultateve të planeve dhe programeve që korrespondojnë me këtë rezultat t'u vendosën numrat, p.sh. në këtë rast numri 1.


Aktiviteti 1: Merrni ndonjë shembull konkret duke zbërthyer rezultatin e fushës kurrikulare të matematikës (RNF) të ndonjë shkalle kurrikulare në rezultat të klasës së caktuar të shkallës përkatëse.

Aktiviteti 2: Krahaso ndonjë rezultat të planeve dhe programeve ekzistuese të matematikës me ato të fushës kurrikulare dhe mundohu ta plotësosh tabelën për shkallën përkatëse, klasën përkatëse.

Për burime shfrytëzo Kurrikulën Bërthamë dhe planin dhe programin ekzistues për lëndën e matematikës.

3. ASPEKTET METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT DHE ZBATIMIT TË KURRIKULËS SË RE, FUSHA E KURRIKULËS MATEMATIKË

Matematika në KKK dhe në KB, sipas niveleve formale të arsimit parauniversitar, është e përfshirë si fushë dhe si lëndë mësimore, prandaj rëndësia e saj është bazike. Gjatë planifikimeve mësimore duhet të jemi të kujdesshëm, të bazohemi te qëllimet dhe parimet e kurrikulës. Duhet të bazohemi në rezultatet e të nxënit të kompetencave të përfshira në KKK, e sidomos në rezultatet e të nxënit të kompetencave të përfshira në KB-të, sipas niveleve përkatëse apo më mirë të themi shkallëve përkatëse (RNSH), te rezultatet e të



nxënit e fushës (RNF), duke ia përshtatur nivelit të shkollimit, shkallës së shkollimit, klasës së shkollimit. Në bazë të këtyre rezultateve dhe koncepteve matematikore të marra nga KB-të caktojmë temat mësimore që do të përfshihen brenda një shkalle, duke i harmonizuar nga klasa në klasë, por duke mos e tejkaluar edhe harmonizimin e temave nga niveli në nivel. Duke pasur parasysh se matematika është shkencë e ndërtuar mbi atë paraprake, pra mbi njohuritë, shkathtësitë dhe përvojat paraprake. Përmbajtjet (temat, konceptet) matematikore janë sikur rathët koncentrikë, p.sh. për bashkësitë numerike (shiko

ilustrimin në anën e majtë), bashkësia e numrave natyrorë mësohet që nga klasa parafillore e vazhdon duke u zgjeruar kjo bashkësi në bashkësinë e numrave të plotë Z, në bashkësinë e numrave racionalë Q. Më pas vërehet edhe bashkësia që nuk i përmban numrat racionalë, bashkësia e numrave irracionalë I, që së bashku e përbëjnë bashkësinë e numrave realë R, mësohet në shkallën IV të shkollës së mesme të ulët, madje mësohet edhe bashkësia e numrave kompleks në shkollimin e mesëm.

Më qëllim që mësimdhënia dhe të nxënit të jenë sa më i suksesshëm, të gjitha fushat kurrikulare, pra edhe fusha e Matematikës, duhet të kalojnë nëpër këto planifikime:

- *Planin mësimor*
- *Planifikimin e shkallës kurrikulare*
- *Planifikimin vjetor*
- *Planifikimin dymujor*
- *Planifikimin javor dhe*
- *Planin e orës mësimore*
- *Të trajtohen çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare.*

3.1 Plani mësimor

- Fusha kurrikulare /lëndë mësimore
- Orë mësimore

Si përgatitet plani mësimor në nivel shkolle?

Para se të bëhet planifikimi më i detajuar i procesit mësimor për një vit shkollor/mësimor (planifikimi vjetor dhe mujor), së pari duhet përcaktuar saktë planin mësimor për klasën, përkatësisht vitin shkollor (mësimor). Në Kurrikulat Bërthamë të të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar ekziston një masë lire në organizimin e planit mësimor. Shih KB-të te pjesa Plani mësimor. Kjo do të thotë se shkolla mund ta hartojë vetë planin mësimor konform kërkesave të KB-së. Ajo mund të lëvizë numrin e orëve brenda fushës së njëjtë të shkallës kurrikulare nga klasa në klasë, apo nga gjysmëvjetori në gjysmëvjetor. Por, kujdes, nuk duhet tejkaluar totali i përgjithshëm i fondit javor që është caktuar me Kurrikulën Bërthamë për secilën klasë dhe totali i orëve të fushës kurrikulare brenda shkallës kurrikulare.

Në KB-të e niveleve arsimore për fushën kurrikulare të Matematikës është përcaktuar numri i orëve mësimore gjatë javës. P.sh. (tabela është marrë nga KB-ja për arsimin e mesëm të ulët, faqe 51.)

Shkolla e mesme e ulët (SNKA 2)

Fusha kurrikulare	Shk. 3				Shk. 4			
	Kl. VI		Kl. VII		Kl. VIII		Kl. IX	
	Nr. orëve	i orëve	Nr. orëve	i orëve	Nr. orëve	i orëve	Nr. orëve	i orëve
Matematika	5		5		4		4	
			10	17.86			8	13.56

Nga ky plan mësimor shohim se shkalla e tretë i ka gjithsej 10 orë mësimore në javë, të ndara 5 orë në klasë të VI dhe 5 orë në klasë të VII. Mirëpo, nëse shkolla, Këshilli i arsimtarëve të shkollës, e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme, për të mirën e nxënësve, ndarjen e orëve, mund ta bëjë ndryshe, p.sh 6 orë në klasë të VI dhe 4 orë në klasë të VII. Duke marrë parasysh fondin e orëve nga plani mësimor dhe kalendari mësimor, planifikojmë planin vjetor për fushën e Matematikës.

Aktivitet 1: Provo me kolegë të shpërndash numrin total të orëve të fushës së Matematikës të një shkalle kurrikulare nëpër klasë sa ka shkalla e caktuar kurrikulare. Së pari lexoni në KB pjesën e planit mësimor dhe rezultatet fushës së Matematikës (RNF), më pas planin mësimor për matematikë paraqiteni në formë tabelare. Pastaj këtë vendoseni në paketën e të gjitha planifikimeve.

3.2 Plani për shkallë të kurrikulës

- *Rezultate të të nxënit për shkallë - kompetenca (RNSH)*
- *Rezultate të të nxënit për fusha kurrikulare (RNF)*
- *Përcaktimi i temave orientuese për klasa*

Planifikimi në nivel shkalle kurrikulare, ndihmon në përcaktimin orientues të procesit mësimor të secilës klasë sa ka shkalla kurrikulare. Gjithashtu, sigurohet vazhdimësi nga klasa në klasë dhe bëhet evitimi i përsëritjeve të paplanifikuara.

Si mund të bëhet planifikimi për shkallë kurrikulare?

Plani për shkallë të kurrikulës është më i përgjithësuar dhe përmban po ato elemente që i ka plani vjetor. RNF-të e shkallëve janë të paraqitura në kurrikulat bërthamë dhe këto rezultate ndikojnë në zhvillimin rezultateve të kompetencave (RNSH, rezultatet e të nxënit për shkallën e caktuar). Pas analizës (krahasimit) së rezultateve të fushës së Matematikës për shkallën e caktuar (RNSH – matematikë), bëjmë përzgjedhjen e atyre që na duken më të përshtatshme për klasën e caktuar (vërejtje: rezultatet mund të përmbushen brenda dy klasave të një shkalle, prandaj ato mund të përsëriten prej klase në klasë). Në bazë të këtyre rezultateve bëjmë analizën dhe krahasimin e planeve aktuale në përdorim për klasat përkatëse (PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR 6, 7, 8, 9 të hartuara nga MASHT-i, gjatë viteve 2003, 2004, 2005) duke u ndalur te lënda e Matematikës. Më lart të hartimi i RNL (te pjesa e këtij udhëzuesi 2.3.3) është paraqitur tabela me të cilën mund të krahasohen rezultatet nga planet dhe programet mësimore aktuale me rezultatet e fushës së KB-së. Mirë është të caktohen temat në bazë të koncepteve matematikore që do të shtjellohen gjatë një shkalle të caktuar.

Apo mund të përdorni edhe këto formate, me qëllim që të përcillen edhe RNSH-të se cilat synohen të arrihen në secilën klasë përmes matematikës.

Tab.1 Shkalla e tretë

Klasa e gjashtë				Klasa e shtatë			
RNSH-kompetencë	Konceptet	RNF.... Matematikës	Tema mësimore	RNSH-kompetencë	Konceptet	RNF.....	Tema mësimore
I.2, I.4, 2.6,.....	Numri dhe algjebra	1, 3,	1. Numrat (natyrorë, thyesor dhe dhjetorë) 2. Bashkësitë (veprimet me				

	a	bashkësi dhe pasqyrimi)				
		RNF... gj- komu.				RNF	

Gjithashtu në tabelë mund të bëhet planifikimi edhe i të gjitha fushave kurrikulare në mënyrë që të shohim prezencën e rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare/kompetencë në të gjitha klasat sa ka shkalla përkatëse, sepse të gjitha rezultatet e kompetencave duhet të arrihen deri në fund të shkallës dhe mund të ndodhë për një moskoordinim jo të mirë midis fushave kurrikulare të mbetet ndonjë rezultat i pasyruar.

Tab 2. **Shkalla e parë**

Shembull i planit për shkallë vetëm me rezultate të të nxënit për shkallë kurrikulare-kompetenca dhe për fusha kurrikulare.

Fusha kurrikulare	Rezultatet	Klasa parafillore	Klasa I	Klasa II
Gjuha dhe komunikimi	Rezultatet e të nxënit të shkallës/kompetencave P.sh. shkalla IV	P.sh. rezultati I.1, II.5, III.5 (i njëjtë)	P. sh. II.1, III.4, III.5 (i njëjtë)	P.sh. I.2, III.4 (i njëjtë), V.4
	Rezultatet e të nxënit të fushës	P.sh. rezultatet II.1 IV.1, II.3	I.2, IV.2 II.3, IV.1	2.1 5.1, V.1
Matematika		II.5,...		

Gjatë këtij planifikimi mund të shohim se cilat rezultate mendojmë t'i synojmë (përsërisim) nëpër klasë. Në këtë tabelë rezultatet e të nxënësve janë vetëm shembuj, ndërlidhja nuk është e saktë. Qëllimi është vetëm të kuptohet ideja se disa rezultate të të nxënësve nëse shihen të arsyeshme mund të barten nëpër klasë e disa jo. Gjithashtu, rezultatet e njëjta mund të synohen edhe nga fushat e tjera kurrikulare. Rezultatet e kompetencave, edhe pse barten nga klasa në klasë, në kuadër të fushës së njëjtë kurrikulare, mund të ndërlidhen me rezultate të të nxënësve të njëjta apo të ndryshme të fushës kurrikulare.

Sidoqoftë, çfarë lloj planifikimi të bëjë për shkallë kurrikulare mund të vendosë vetë mësuesi, duke pasur parasysh funksionin e tij të mëvonshëm në planifikimet vjetore për klasat e shkallës së caktuar kurrikulare.

3.3 Plani vjetor





Plani vjetor përmban këto elemente:

- *Konceptet e fushës kurrikulare marrë nga KB-ja për shkallën e caktuar;*
- *Rezultatet e të nxënit për shkallën e caktuar- kompetencat, marrë nga KB-ja;*
- *Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare marrë nga KB-ja për shkallën e caktuar;*
- *Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor. Temat shpërndahen (organizohen) në 5 cikle dymujore.*

Plani vjetor¹ është dokument, i cili e orienton zhvillimin e mësimimit për një vit shkollor (mësimor), duke i përmbushur kërkesat e shkallës kurrikulare, duke i ndarë apo duke i thjeshtuar për klasën e caktuar. Pasi që ka shkallë me numra të ndryshëm të klasave 3, 2 ose 1 (Shih KKK, faqe 31). Ai hartohet për secilën fushë kurrikulare dhe ka për qëllim identifikimin e rezultateve të të nxënit të kompetencave, të cilat mund të jenë si synim arritjeje gjatë një viti shkollor (mësimor), identifikimin e koncepteve dhe rezultateve të të nxënit të fushave kurrikulare nga të cilat do të përcaktohen përmbajtjet mësimore. Ky planifikim mbështetet në planifikimin për shkallë kurrikulare, por edhe kërkon konsultë të vazhdueshme të KB-së, respektivisht të shkallës së caktuar kurrikulare.

Si bëhet planifikimi vjetor?

Shembull, hapat që duhet ndjekur për planifikim vjetor, klasa e gjashtë, por duke konsultuar KB-në, fushën e Matematikës.

Hapi 1 	Hapi 2 	Hapi 3 	 Hapi 4
RNSH –kompetencat	Konceptet	RNF	Tema mësimore
I.2, I.4, 2.6,.....	Numri dhe algjebra	1, 3,...	1. Numrat (natyrorë, thyesor dhe dhjetorë) 2. Bashkësitë (veprimet me bashkësi dhe pasqyrimi)

¹¹ Në shtojcë është bashkangjitur plani vjetor nga shkollat pilot

Apo mund të ndiqen këta hapa, **shembull, gjithnjë duke konsultuar KB-në:**

Hapi 1	hapi 2	hapi 3	Hapi 4
Konceptet	RNF	Tema mësimore	RNSH –kompetencat
Numri dhe algjebra	1, 3,...	1. Numrat (natyrorë, thyesor dhe dhjetorë) 2. Bashkësitë (veprimet me bashkësi dhe pasqyrimi)	I.2, I.4, 2.6,.....

U mbetet mësimdhënësve të vendosin se me çfarë hapa do të bëjnë planifikimin. Por, planifikim për shkallë duhet bërë gjithsesi.

RNSH-të shih në KB të secilit nivel, konceptet kryesore dhe RNF për fushën e Matematikës i gjeni në Kurrikulat Bërthamë (KB) të niveleve përkatëse 1,2 dhe 3.

Pasi që përcaktojmë konceptet dhe rezultatet e të nxënit për fushën kurrikulare (RNF), të cilat korrespondojnë me konceptet, atëherë përcaktojmë përmbajtjen mësimore (temat mësimore). Përmbajtja mësimore duhet të jetë në funksion të mësimdhënies së integruar brenda fushës kurrikulare (disiplinave matematikore), por edhe të fushave të tjera kurrikulare. Puna me tema të përbashkëta mësimore brenda fushës kurrikulare (disiplinave matematikore) dhe lidhshmëria me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare janë në linjë të mësimdhënies dhe të nxënies së integruar, e cila duhet të synohet në vazhdimësi. *Temat mësimore janë tërësi mësimore, të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë disiplinat mësimore matematikore bashkërisht brenda fushës kurrikulare të Matematikës.*

Planifikimi vjetor duhet të bëhet nga mësimdhënësit e matematikës që japin mësim në shkallën, klasën përkatëse. Pas përgatitjes u jepet që ta analizojnë mësimdhënësit e matematikës që japin mësim në shkallët e tjera, mundësisht edhe në shkollat e tjera. Ripërpunohet duke marrë parasysh mendimet dhe sugjerimet e tyre. Është mirë të diskutohet edhe me të gjithë mësimdhënësit që japin mësim në shkallët, klasat përkatëse, e sidomos me mësimdhënësit e shkencave të natyrës. Sepse nga përvojat e deritanishme në shkollat e mesme të ulëta të këto lëndë veprimet matematikore më të avancuara kryhen para se të zhvillohen me nxënës në lëndën e matematikës. P.sh. veprimet me numra dhjetorë, veprimet me fuqi, njësitë matëse etj.

Temat mësimore mund të jenë pranishme për disa muaj gjatë vitit shkollor (mësimor), por edhe gjatë tërë vitit shkollor. Kjo varet nga nevojat e nxënësve dhe nga rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare. P.sh. kl. X


Koncepti	RNF	Tema	IX -X	XI-XII	I-II	III-IV	V-VI
Algjebra	1, 2	Algjebra	√	√	√	√	

Në shkollën e mesme të lartë konceptet mund t'i hasim edhe si tema mësimore, përshkrimi i temës i thellon dhe i dallon nga muaji në muaj.

Me rastin e përzgjedhjes të temave mësimore duhet pasur parasysh përvojat, interesat dhe mundësitë e nxënësve, d.m.th. nuk mund të kalohet në temën tjetër pa u arritur rezultatet e planifikuara.

Për secilën temë mësimore duhet caktuar edhe rezultatet e të nxënësve për shkallë kurrikulare /kompetenca (RNSH) që synohen të arrihen nga tema në fjalë. Rezultatet e të nxënësve për shkallë kurrikulare - kompetencë mund të shënohen me numra rendorë, ashtu siç janë në KB – për shkallën përkatëse. Për çështje praktike, edhe rezultateve të të nxënësve të fushës kurrikulare (RNF), po ashtu edhe të temës mësimore, mund t'u vendoset nga një numër rendor. Numrat rendorë të jenë të njëjtë për rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare dhe temës mësimore që korrespondojnë me njëri-tjetrin.

Me rastin e planifikimit vjetor mund të shfrytëzojmë burime të ndryshme që na ndihmojnë në identifikimin e nivelit shkencor të temave mësimore të përzgjedhura, por edhe të nivelit pedagogjik në raport me moshën e nxënësve. Gjithashtu, identifikimin e burimeve bazë për nxënës që janë në funksion të arritshmërisë së kompetencave dhe rezultateve të fushave kurrikulare.



Temat mësimore pas përzgjedhjes shpërndahen në ciklet dymujore të planifikimit vjetor. Shih tabelën e planifikimit vjetor të procesit mësimor.

Ja si duket skeleti i një planifikimi vjetor:

Tabela e planifikimit vjetor të procesit mësimor

Fusha e kurrikulës:

Viti shkollor

Klasa:

Fusha e kurrikulës	Koncept et e fushës kurrikulare (marrë nga KB)	Rezultatet e fushës së kurrikulës bërthamë - KB (marrë nga KB)	Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilin fushë kurrikulare	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve					Rezultatet e kompetencave, (Rezultatet e të nxënimit për shkallë)
				Shtator-tetor	Nëntor - dhjetor	Janar- shkurt	Mars-prill	Maj -qershor	
Gjuhët dhe komunikimi									
Artet									
Matematika									

Preferohet që në tabelën e planifikimit vjetor të vendosen të gjitha fushat kurrikulare në mënyrë që lidhshmëria ndër-fushore të jetë sa më e pranishme dhe gjithashtu kontrollimi i përfshirjes së rezultateve të të nxënimit për shkallë kurrikulare (kompetenca). Kjo na mundëson të kemi një pasqyrë të saktë të rezultateve të të nxënimit të shkallëve kurrikulare (kompetencave).

Udhëzime për plotësim të tabelës

- Ky format i tabelës përdoret për planifikim për secilën klasë;
- Planifikimi për të gjitha fushat kurrikulare të jetë i shkurtër dhe i qartë. Kjo formë e planifikimit u mundëson të gjitha fushave kurrikulare të kenë qasje te njëra-tjetra dhe hetohet që në shikim të parë.

- Me rastin e hartimit të temave mësimore merren për bazë konceptet e fushës kurrikulare dhe rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare (RNF). Ato merren nga Kurrikula Bërthamë për shkallë. Konceptet e fushës kurrikulare janë të vlefshme për gjithë shkallën, përkatësisht për gjithë arsimin parauniversitar (shih KB-fushat e kurrikulës), por mësuesi mbi bazën e këtyre koncepteve duhet të seleksionojë temat për secilën klasë sa ka shkalla.

- Në kolonën e emërtuar **Konceptet e fushës kurrikulare** shënohen vetëm ato koncepte të cilat trajtohen në klasën e caktuar, por të gjitha ato domosdoshmërisht duhet trajtuar gjatë shkallës kurrikulare. Konceptet merren nga KB, f. 34, e nivelit pjesë e së cilës është klasa e caktuar;
- Në kolonën e emërtuar **Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare** vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temë mësimore, pra vetëm ato nga të cilat dalin temat mësimore – origjinale, marrë nga KB.
- Në kolonën e emërtuar **Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilin fushë kurrikulare** shënohen të gjitha temat mësimore që do të trajtohen brenda një viti shkollor (mësimor). Temat mësimore përbëhen prej disa njësive mësimore. Në këtë tabelë shkruhen vetëm temat, e jo njësitë mësimore. Temat mësimore janë të vlefshme për disiplinat e matematikës bashkërisht që ka fusha. Njësitë mësimore janë ato që i bëjnë të dallojnë disiplinat brenda fushës kurrikulare. Njësitë mësimore edhe pse janë të ndryshme nga disiplina në disiplinë, brenda fushës kurrikulare të Matematikës ato synojnë temën e përbashkët, secila prej këndit të vet.
- Në kolonën e emërtuar **Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve** bëhet shpërndarja e temave të përzgjedhura për një vit mësimor nëpër muaj.

Në shtrirjen dymujore temat zërthen me më pak fjalë se çfarë do të trajtohet brenda tyre (shumë shkurt - ndoshta në formë të nëntemave me disa sqarime po në formë të pyetjeve-aktiviteteve).

Brenda dy muajsh mund të trajtohen disa tema mësimore, 1, 2 tema apo më shumë, varësisht sa mësuesi mendon se janë të nevojshme të trajtohen brenda muajve (preferohet numri i vogël i temave). Disa tema mund të jenë të pranishme edhe në muajt e tjerë,

kuptohet me njësi të reja mësimore. Renditja e temave nëpër muaj sugjerohet të bëhet sipas një rendit logjik.

- Në kolonën **rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare–kompetenca** shkruhen vetëm rezultatet për kompetenca që mendohet se duhet të arrihen përmes temave. Këto rezultate mund t'i gjeni te rezultatet e të nxënit të shkallëve kurrikulare, pjesë e së cilës është klasa për të cilën do të planifikoni.

Në këtë kolonë rezultatet i shënoni me numra rendorë, origjinale, ashtu si janë në KB.

Mësimdhënësi i përcakton se cilat kompetenca – rezultate të të nxënit për shkallë-kompetenca synon t'i arrijë përmes fushës kurrikulare gjatë një viti mësimor, respektivisht përmes temës mësimore.

Bashkërisht të gjitha fushat kurrikulare për sa klasë që ka shkalla duhet synuar të arrijnë të gjitha rezultatet e kompetencave d.m.th., nëse shkalla ka tri klasë atëherë për tri vite shkollore-mësimore një gjeneratë që i takon shkallës së caktuar duhet t'i arrijë të gjitha rezultatet e kompetencave të parapara për shkallën e caktuar në Kurrikulën Bërthamë.

Mësimdhënësit duhet të vendosin se cilat nga rezultatet e të nxënit për shkallë të tretë - kompetencë do t'i synojë t'i arrijë në klasën gjashtë dhe cilat në klasën e shtatë.

Ka raste kur një rezultat i ndonjë kompetencë mund të synohet të arrihet në dy klasa radhazi, kjo i mbetet mësimdhënësit të vendosë. **Kujdes, rezultatet duhet të arrihen nga secili nxënës!**

Procedurat e nevojshme për plotësim të tabelës

- Tabela punohet nga aktivet profesionale të shkollës e në këtë rast edhe nga aktivi profesional i matematikës;
- Për secilën fushë kurrikulare punojnë bashkërisht mësimdhënësit e lëndëve që i takojnë fushës së caktuar kurrikulare. Kjo vlen për shkollën e mesme të ulët dhe shkollën e mesme të lartë. Pra, mësimdhënësit e matematikës planifikojnë bashkërisht;
- Në shkallën e parë dhe të dytë (shkollë fillore) punojnë të gjithë mësuesit e paraleleve sa ka klasa e caktuar, por në këtë grup duhet të kontribuojë një përfaqësues i secilës fushë kurrikulare të shkollës së mesme të ulët;
- Pasi që planifikimi vjetor punohet për fushën e caktuar, për klasën e caktuar, atëherë mblidhet Këshilli i klasës së caktuar dhe bashkërisht planifikimin e secilës fushë e vendosin në formatin/ tabelën e përbashkët. Gjatë vendosjes në këtë tabelë përfaqësuesit e fushave të klasës së caktuar (në shkollën fillore mund të jenë mësues klase) diskutojnë për përmbajtjen dhe kompetencat që synon t'i arrijë secila fushë për klasën e caktuar, në mënyrë që ndërlihdja në mes të fushave të jetë sa më e pranishme.

Aktiviteti 1: Me kolegë të fushës tuaj identifikoni RNSH/kompetenca të një shkalle të caktuar, që mund të realizohen përmes fushës së Matematikës gjatë një viti shkollor (konsulto planifikimin për shkallë). Më pas identifikoni RNF-të e matematikës që korrespondojnë me RNSH dhe caktoni temat mësimore.

Aktiviteti 2: Me kolege të fushave të tjera kurrikulare diskutoni se cilat rezultate të kompetenca po synoni t'i arrini dhe mundohuni të bëni ndërlidhjen e temave tuaja mësimore me temat e tyre mësimore.

Dhe, në fund përgatiteni planifikimin vjetor për fushën e Matematikës.

3.4 Plani dymujor

Plani dymujor përmban këto elemente:

Temat mësimore, RNSH (kompetenca), RNF, korrelacionin dhe çështjet ndërkurrikulare, lëndën mësimore, RNL, njësitë mësimore, kohën e nevojshme, metodologjitë e mësimdhënies dhe vlerësimin dhe burimet.

Si bëhet planifikimi dymujor?

Planifikimi dymujor është vazhdimësi e planifikimit vjetor të fushës së Matematikës dhe si tërësi e këtyre planifikimeve ka formatin e një programi mësimor. Gjatë një viti shkollor (mësimor) bëhen pesë planifikime dymujore. Ky planifikim hartohet për dy muaj dhe vetëm për një temë mësimore. Kjo do të thotë se nëse në planifikim vjetor është paraparë që brenda dy muajsh të trajtohen dy tema mësimore, atëherë duhet bërë dy planifikime dymujore për muajt e njëjtë. Planifikimi mund të bëhet në të njëjtin formular-tabelë, vetëm me vazhdimësi.

Planifikimi dymujor ka për qëllim zbrëthimin e temave mësimore të fushës së matematikës, që vetëm janë përcaktuar në planifikimin vjetor në njësi mësimore. Njësitë mësimore bashkërisht duhet të kenë për synim arritjen e rezultateve të identifikuar të nxënësit të shkallës kurrikulare (kompetencave) dhe të fushës kurrikulare të synuara të arrihen nga tema e caktuar mësimore për klasën e caktuar. Gjithashtu, planifikimi dymujor ka për qëllim identifikimin e rrugëve (metodologjisë), mjeteve (materialeve) dhe burimeve për arritjen dhe vlerësimin e nivelit të arritjes së këtyre rezultateve. Elementet e planifikimit dymujor shihni në tabelën e emërtuar **Planifikimi dymujor i procesit mësimor**.

Tema mësimore e përzgjedhur mund të ketë lidhshmëri edhe me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare. Këtë lidhshmëri duhet shikuar në planifikimin e përbashkët vjetor me fushat e tjera kurrikulare, me qëllim që të bëhet pjesë e planifikimit dymujor dhe kështu të mundësohet mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar. (Lexo në pjesët më poshtë të udhëzuesit- korrelacionin).

Po ashtu, pjesë e planifikimit mund të jenë çështjet ndërkurrikulare, si të drejtat e njeriut, çështjet gjinore..., të cilat mund të korrespondojnë me temën e përzgjedhur, shih pjesën çështjet ndërkurrikulare në KB - në përmbajtjen e secilës fushë kurrikulare, po ashtu edhe udhëzuesin më poshtë. Të dhënat e marra për këto çështje mund të shndërrohen në numra dhe problema matematikore dhe njëkohësisht të trajtohen në aspektin social.

*P.sh. metrat katrorë të paktë në vendbanimin e një familje, apo të ardhurat e pakta për kokë anëtarit të familjes etj., mund të jenë faktorë destabilizues në familje (këto çështje duhet pasur kujdes se i të trajtohen me nxënës, sepse janë çështje të ndjeshme!) pastaj numri i madh i automjeteve, sa lirojnë gazra - dendësia e gazrave sa e ndot mjedisin? dhe shembuj të tjerë të natyrave të ndryshme **SHËNDËRRONI NË PROBLEME MATEMATIKE.***

Për t'i trajtuar këto çështje mund të përcillni edhe ditët ndërkombëtare, si Dita e tokës, Të drejtat e njeriut, 8 Marsin, etj. Çështjet të përzgjidhen konform interesave të nxënësve të moshave të caktuara.

Planifikimi dymujor i temës mësimore në njësi mësimore mundëson arritjen e rezultateve të kompetencave dhe të fushës kurrikulare që janë planifikuar në planifikimin vjetor për temën e caktuar.

Zbërthimit të temës mësimore në njësi mësimore duhet t'i paraprijë zbërthimi i rezultateve të fushës kurrikulare në rezultate të të nxëniet për klasën e caktuar.

Mësimdhënësi-ja gjatë zbërthimit të rezultatit të fushës në rezultatet e të nxëniet për klasë mund të shfrytëzojë planet dhe programet ekzistuese apo rezultatet përfundimtare marrë nga tabela krahasuese e rezultateve të fushës kurrikulare të KB-ve me rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese për shkallën e caktuar, të cilën e ka krahasuar vetë, (shih materialin më lart, pjesën 2.3.3, Rezultatet e të nxëniet për klasë në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore-RNL brenda shkallës kurrikulare). Nga kjo tabelë mund të zgjidhen vetëm ato rezultate që janë në funksion të rezultatit të fushës nga i cili është dalë tema mësimore. Në të kundërtën, mësimdhënësi-ja mund edhe t'i hartojë vetë. Pas shkrimit të rezultateve të lëndës mësimore (fushës kurrikulare) për klasë përcaktohen njësitë mësimore.

Shih skemën e zërthimit të rezultateve të fushës kurrikulare (RNF) në rezultate të të nxënit për lëndë - për klasë (RNL) nga të cilat dalin temat mësimore (TM) dhe njësitë mësimore (NJM) dhe shembullin procesit të përcaktimit të njësive mësimore.



Shembull: Procesi i përcaktimit të njësive mësimore, klasa e gjashtë

Hapi 1	hapi 2	hapi 3	Hapi 4	Hapi 5
RNSH (kompet enca)	RNF- Matematikë	Tema mësimore	RNL	Njësia mësimore
I.1 cI.6 II.4 III.3	3, 4, 8	Numrat natyrorë	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri ne klasën e miliardave ; ✓ Identifikon vend vlerën e shifrës ne numrin e dhënë; ✓ Krahason numrat natyrorë dhe i renditë ata sipas madhësisë; ✓ Rrumbullakon numrat natyrorë në dhjetëshen, qindëshen, ... më të afërt dhe i paraqet në boshtin numerik. 	Numrat natyrorë <ul style="list-style-type: none"> ✓ Leximi dhe shkrimi; ✓ Krahasimi; ✓ Rrumbullakimi; (Paraqitja në boshtin numerik).

(Shih në shtojcë planifikimet dymujore).

Përzgjedhja e njësive mësimore, sikurse temat mësimore, duhet të bëhet konform përvojave, mundësive, interesave të nxënësve dhe të ndërlidhen me jetën dhe aktualitetin.

Më poshtë shih tabelën e **planifikimit dymujor** dhe **udhëzimet** për plotësimin e saj.

Tabela e planit dymujor për procesin mësimor

Fusha: Matematikës

Klasa:

Muajt:

Tema mësimore:.....

Rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen përmes temës:

Rezultatet e fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës:

Korrelacioni me fushat kurrikulare:

Çështjet ndërkurrikulare:

Fusha apo lëndët mësimore	Rezultatet e të nxëniet të lëndës	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet
Matematikë						

Udhëzime për plotësim të pjesës narrative dhe tabelës

Pjesa narrative

Planifikimi

Planifikimi dymujor sipas këtij formulari bëhet për një temë mësimore. Nëse brenda dy muajve në planifikim vjetor janë paraparë dy apo më shumë tema, atëherë duhet për secilën temë të bëhet planifikimi. Planifikimi mund të bëhet në të njëjtin formular (tabelë), në vazhdimësi.

Temat mësimore

Tema mësimore merret nga tabela e planifikimit vjetor të temave të fushës së kurrikulës (Matematikë) sipas planifikimeve për dy muaj, respektivisht shtrirjes dymujore.

Rezultatet e të nxëniet për shkallë - të kompetencave

Nga kompetencat që janë paraparë të arrihen te planifikimi vjetor - marrë nga KB, barten vetëm ato rezultatet të të nxëniet për shkallë RNSH- kompetenca që synohen të arrihen përmes temës mësimore. Tani rezultatet shkruhen me numra rendorë dhe me narracion si janë në KB. Mund të jenë një, dy, apo më shumë rezultate.

Rezultatet e fushës kurrikulare

Shënohen vetëm ato rezultate të të nxënit të fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës së caktuar mësimore. Rezultatet duhet të merren nga planifikimi vjetor që janë marrë nga KB - shkalla e caktuar kurrikulare. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate. Është mirë që për çështje praktike edhe rezultateve të fushave kurrikulare t'u vendosen numrat rendorë të njëjtë, ashtu si u kemi vendosur në planifikimin vjetor. Gjithashtu, t'u shkruhet edhe narracioni, siç janë në KB.

Korrelacioni dhe çështjet ndërkurrikulare

Korrelacioni bëhet mbi bazën e planifikimit vjetor të fushave kurrikulare. Me pak fjalë përshkruani korrelacionin e temës që planifikohet me temat e fushave të tjera. Duhet të bëhet ndërlidhja e temës mësimore me çështjet ndërkurrikulare, si: të drejtat e njeriut , toleranca,... shih KB- çështjet ndërkurrikulare.

Plotësimi i tabelës

Lëndët mësimore

Shënohen lëndët mësimore që janë në kuadër të fushës kurrikulare, e në këtë rast është Matematika.

Rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore

Mësimdhënësi-sja shkruan rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore nga të cilat dalin njësitë mësimore. Në këtë rast mund t'i konsultojë-marrë nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me KB (pra rezultatet e lëndës duhet dalë nga rezultatet e fushës (shih shembullin më lart të zbërthimit të RNF në RNL). Mund të jenë një ,dy, apo më shumë rezultate. Por, edhe mund t'i hartojë vetë.

Secilit rezultatet të të nxënit të lëndës t'i vendoset një numër rendor.

Njësitë mësimore

Njësitë mësimore shënohen për lëndë mësimore –Matematikë. Mësimdhënësi-ja përcaktohet për ato njësi mësimore që dalin nga rezultatet të nxënit të lëndës mësimore për klasë dhe që janë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit të fushës dhe kompetencave të caktuara për temën që është marrë nga planifikimi vjetor.

Koha e nevojshme

Mësuesi duhet të konsultojë planin mësimor që e ka zbërthyer nga KB për klasë. Ai vendos sa kohë (orë mësimore) i nevojitet, përmes njësive mësimore, të arrihen rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore, zhvillimit të kompetencave të caktuara te nxënësit (arritshmërinë e rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare dhe kompetencave).

Metodologjia

Të shkruhet në formë të aktiviteteve, duke i përmendur metodat dhe teknikat e mësimdhënies dhe të nxënësve, jo shumë të detajuara, sepse kjo bëhet në planin e orës mësimore.

Vlerësimi

Vlerësimi të paraqitet në formë të aktiviteteve dhe me çfarë instrumente bëhet ai. P.sh. test, ese, listë kontrolli, pyetësor etj.

Burimet dhe materialet mësimore

Të shkruhen burimet që mësimdhënësi dhe nxënësit i shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të caktuara. Ato mund të jenë të ndryshme (burimet e shkruara, elektronike, njerëzore etj.)

Burimet e shkruara mund të jenë tekste mësimore, gazeta, revista, dokumente dhe materiale të ndryshme.

Burimet elektronike: interneti-ueb-faqja , TV-kanali-emisioni, radio.

Burimet njerëzore mund të jenë njerëzit që janë pjesë e një historie, ngjarje, pune, etj.

Materialet mësimore: instrumentet e nevojshme për mësimin e matematikës.

Sugjerim

Një planifikim i mirë kërkon bashkëpunim brenda aktiveve profesionale, Këshillit të klasës, d.m.th .bashkërisht mësimdhënësit e matematikës planifikojnë dhe më pas diskutojnë edhe me fushat e tjera kurrikulare!

Aktivitet: Pasi që i keni lexuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për PLANIFIKIMIN DYMUJOR, diskutoni me kolegë të fushës së suaj dhe përgatiteni një plan dymujor për fushën e kurrikulës Matematika.

3.5 Plani javor²

Meqenëse plani dymujor nuk është i ndarë në javë, plani javor mundëson përcaktimin e njësive mësimore, të cilat do të realizohen gjatë javës për secilën lëndë mësimore (fushë kurrikulare), në klasën e caktuar. Njësitë mësimore merren nga planifikimi dymujor.

Planifikimi javor ka për qëllim lidhshmërinë e njësive mësimore të lëndëve të ndryshme mësimore në kontekst të kuptimit të situatave, problemeve, dukurive dhe ngjarjeve, si çështje të ndërlidhura e jo të ndara.

Si bëhet plani javor?

Të gjithë mësimdhënësit/set e një klase (p.sh. kl. VI apo kl. X apo...), të të gjitha fushave kurrikulare, të të gjitha lëndëve, në një tabelë të përbashkët të vendosin njësitë mësimore që i kanë planifikuar t'i realizojnë gjatë javës për një klasë (edhe pse ato mund të jenë të ndryshme nga arsimtarët e së njëjtës lëndë, por që japin mësim në paralele të tjera brenda klasës së njëjtë).

Kjo qasjeje i obligon mësimdhënësit që të takohen gjatë javës dhe që të bëhet lidhshmëria e njësive mësimore ndërmjet lëndëve të ndryshme, në mënyrë që të nxëniet e nxënësve të jetë më i integruar.

Nëse ky takim për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta nuk mund të jetë i realizuar në të gjitha shkollat, sepse “kolektivi i mësimdhënësve është shumë i madh”, atëherë kryetari i Këshillit të klasës (p.sh. kryetari i Këshillit të paraleleve të klasës së gjashtë apo të klasës së dhjetë, apo...) mund të qarkojë fletën-tabelën në të cilën mësimdhënësit shkruajnë njësitë mësimore që do t'i zhvillojnë javën që vjen, ose pedagogu i shkollë në shkollat ku ka pedagog. Më pas kjo fletë-tabelë e përfunduar shumëzohet ose shpërndahet në mënyrë elektronike të të gjithë mësimdhënësit/set e klasës së njëjtë para javës që realizohen njësitë mësimore.

Është e nevojshme që planifikimi javor të publikohet edhe në sallën e mësimdhënësve, në mënyrë që të gjithë mësimdhënësit të jenë në dijeni se cilat tema/njësi mësimore realizohen gjatë javës dhe të ndihmojnë integrimin përmbajtjesor të fushave dhe lëndëve të kurrikulës.

Qasja e prezantimit/publikimit të planit javor para të gjithë mësimdhënësve është një qasje e re në traditën e planifikimit mësimor. Jetësimi në praktikë kërkon bashkëpunim

² Në shtojcë kemi bashkangjitur planifikime javore të marra nga disa shkolla pilot.

brenda aktiveve profesionale, bashkëpunim në mesin e të gjithë mësimeve. Vlerësohet se kjo qasje mund të ndikojë në lehtësimin e të nxënësve, në zvogëlimin e ngarkesës së nxënësve në provime dhe testime, sidomos nëse bëhet kujdes që të vendosen tema/njësi mësimore, ndihmohen reciprokisht në mes të fushave të kurrikulës dhe lëndëve mësimore dhe nëse bëhet një përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe aktiviteteve që do të zhvillohen brenda një klase të caktuar.

Para se të bëhet planifikimi javor i gjitha lëndëve mësimore sa ka klasa e caktuar, në këtë rast është mirë që edhe mësuesit e fushës së Matematikës së pari të koordinojnë planifikimin e tyre për javë për të qenë të gatshëm për planifikim të përbashkët me të gjitha lëndët mësimore në nivel klase. Shih shembujt më poshtë.

Shembulli1: Planifikimi i fushës së Matematikës

Klasa:

Muaji:

Java e:

Ditët e javës	NJESIT MESIMORE	KORELACIONI NDËRFUSHOR DHE ME FUSHAT TJERA KURRIKULARE
E hënë		
E martë		
E mërkurë		
E enjte		
E premte		

(Ju mund të bëni edhe formularë të tjerë konform kërkesave tuaja)

Shembulli 2: Plani i përbashkët me fusha/lëndë të tjera

Klasa:

Muaji:

Java e:

Dita	Njësitë mësimore në javë						
E hënë	Lënda:	Lënda:	Lënda	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Korrelacioni i lëndës së matematikës me lëndët respektivisht me njësitë mësimore të lëndëve të tjera. Gjithashtu të shënohen edhe korrelacionet e lëndëve të tjera me njëra-tjetrën.
E martë	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E mërkurë	Lënda:	Lënda:	Lënda	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E enjte	Lënda:	Lënda:	Lënda	Lënda:	Lënda:	Lënda:	
E premte	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	Lënda:	

Për t'u bërë i mundshëm ky korrelacion, **mos i harroni** diskutimet e përbashkëta gjatë planifikimit vjetor për të vazhduar më pas edhe gjatë planifikimeve dymujore.

Bashkëpunimi i gjithë mësimdhënësve të fushave të ndryshme në këtë drejtim, në fillim do të jetë sfidë por më pas do t'u sjellin kënaqësi rezultatet e nxënësve.

Aktivitet: Pasi që keni analizuar shembullin e dhënë për PLANIN JAVOR, diskutoni me kolegë të fushës së Kurrikulës së Matematikës dhe identifikoni nga planifikimi dymujor njësitë mësimore që do t'i realizoni dhe përgatitni një plan javor, për fushën e kurrikulës së Matematikës (shih shtojcën e planit javor për fushën e Matematikës) dhe pastaj bashkë me kolegët e fushave të tjera kurrikulare, respektivisht të lëndëve të tjera mësimore e përgatitni një plan javor për të gjitha lëndët mësimore.

3.6 Plani i orës mësimore

Plani i orës³ mësimore ka për qëllim që të gjitha planifikimet e procesit mësimor t'i bëjë të zbatueshme në punën e drejtpërdrejtë me nxënësit-set në klasë, por edhe jashtë saj, brenda një ore mësimore. Planifikimi i orës mësimore është planifikim që bëhet në bazë të planit dymujor dhe javor.

Çfarë duhet të përmbajë plani i orës mësimore?

Në këtë planifikim mësimdhënësi-ja përcakton:

- Njësinë mësimore, të cilën do ta realizojë (njësia mësimore merret nga planifikimin dymujor, përkatësisht planifikimi javor);
- Rezultatet e të nxënit të synuara për shkallë-kompetenca (të cilat i ka përcaktuar në planifikimin dymujor të temës mësimore nga fusha e Matematikës);
- Rezultatet e të nxënit të synuara të fushës kurrikulare të Matematikës;
- Rezultatet e të nxënit të lëndës (fushës) mësimore par klasë/orës që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të Matematikës - edhe këto merren nga planifikimi dymujor;
- Kriteret e suksesit, të cilat duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës dhe duhet të jenë në shërbim të rezultatit apo rezultateve të të nxënit të lëndës /orës.

Të gjitha rezultatet e kompetencave, të fushave kurrikulare dhe të lëndëve mësimore, duhet të shënohen me numra rendorë, të njëjtë si janë në planifikimin vjetor, e më pas në planifikimin dymujor, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë të realizimit, përkatësisht arritshmërisë së tyre.

Mbi bazën e rezultateve të kompetencave dhe të fushës kurrikulare të Matematikës, mësimdhënësi-ja e elaboron orën mësimore duke përcaktuar edhe elemente të tjera, të cilat i sheh të nevojshme. Mënyra organizative e orës mësimore - metodologjia e mësimdhënies dhe e vlerësimit, metodat, teknikat, mjetet dhe burimet që shfrytëzohen për realizim të njësisë mësimore duhet të jenë në funksion të rezultateve të të nxënit të planifikuara për arritje.

Mësimdhënësi-ja mund të **përdorë formate të ndryshme** të planifikimit të orës mësimore, por çdoherë duhet pasur parasysh rezultatet e të nxënit të kompetencave dhe të fushës kurrikulare të Matematikës. Shih format e mundshme të planit mësimor.

³ Në shtojcë kemi bashkangjitur plane të orëve mësimore të marra nga disa shkolla pilot.

PLANIFIKIMI/PLANI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare:	/ Lënda: Shkalla e kurrikulës: / Klasa:
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës:	
Tema / njësia mësimore:	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën ____:	<div style="border: 1px solid red; padding: 5px; background-color: #D3D3D3;"> Për çështje praktike mund t'i shkruani me numra si i keni marrë nga planifikimi dymujor. </div>
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën ____:	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE	
Fjalët kyçe:	
Rezultatet e të nxënit të lëndës/orës (RNL):	<div style="border: 1px solid red; padding: 5px; background-color: #D3D3D3;"> Merrni nga planifikimi dymujor </div>
Kriteret e suksesit:	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:	
Përdorimi i TIK-ut:	<div style="border: 1px solid red; padding: 5px; background-color: #D3D3D3;"> Shih në udhëzues se çka janë korrelacioni dhe çështjet ndërkurrikulare </div>
Korrelacion me fushat kurrikulare apo çështje ndërkurrikulare:	
PËRSHKRIMI METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIFIKUAR TË ORËS MËSIMORE	
Pjesa hyrëse:	
Pjesa kryesore:	
Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënit:	

Aktivitet : Mbi bazën e këtij modeli apo modelit tuaj të planit të një orë mësimore përgatit një plan të orës mësimore dhe mundohu të parashikosh se si do t'i synosh RNSH dhe RNF qoftë përmes përmbajtjes, por edhe metodologjisë se mësimdhënies dhe vlerësimit.

3.7 Çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare paraqesin përmbajtje të rëndësishme kurrikulare, të cilat nuk i takojnë ekskluzivisht vetëm një lëndë. Ato realizohen përmes lëndëve të ndryshme kurrikulare (mësimore) dhe janë në funksion të zhvillimit të kompetencave, respektivisht të arritshmërisë së rezultateve të të nxënësve për shkallë kurrikulare. Përmbajtjet e tyre dalin nga edukimi për paqe, të drejtat e njeriut, edukimi ndërkulturor, shkathtësitë e komunikimit, çështjet gjinore dhe edukimi qytetar, duke përfshirë edhe ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe kujdesin e mjedisit, edukimin për karrierë dhe aftësitë për jetë.

Si realizohen çështjet ndërkurrikulare?

Çështjet ndërkurrikulare mund të integrohen në kurrikulë nëpërmjet njësive tematike dhe njësive mësimore, nëpërmjet aktiviteteve praktike në klasë, por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare.

Kështu, me rastin e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore në fusha të caktuara kurrikulare, pra edhe në Matematikë, këto çështje duhet të merren parasysh. Pra, me rastin e paraqitjes së problemave matematikore, përmbajtjet e këtyre problemeve mund të jenë shembuj nga çështjet e lartpërmendura. **Kujto!** Shih shembullin që është paraqitur edhe te planifikimi dymujor.

*P.sh. metrat katrorë të paktë në vendbanimin e një familje, apo të ardhurat e pakta për kokë anëtarit të familjes etj., mund të jenë faktorë destabilizues në familje (këto çështje duhet pasur kujdes se i të trajtohen me nxënës, sepse janë çështje të ndjeshme!). Pastaj numri i madh i automjeteve, sa lirojnë gazra - dendësia e gazrave sa e ndot mjedisin dhe shembuj të tjerë të natyrave të ndryshme **SHËNDËRRONI NË PROBLEME MATEMATIKE.***

Për t'i trajtuar këto çështje mund të përcillni edhe ditët ndërkombëtare, si Dita e tokës, Të drejtat e njeriut, 8 Marsi, etj. Çështjet të përzgjidhen konform interesave të nxënësve të moshave të caktuara.

Shembujt e tillë kontribuojnë në arritjen e kompetencave si Kontribuues produktivë, por edhe në kompetencën Qytetar i përgjegjshëm (lexo RNSH-të e këtyre kompetencave në KB).

Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare mund të bëhet edhe përmes projekteve hulumtuese dhe projekteve të natyrave të ndryshme, p.sh. projekteve promovuese (të vlerave shoqërore, produkteve), projekteve parandaluese etj. Për realizimin e këtyre projekteve mund të kontribuojnë disa fusha kurrikulare, p.sh. në hulumtimin e shkëljes së të drejtave të fëmijëve mund të kontribuojnë fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi,

përmes mënyrës së shkrimit dhe prezantimit të hulumtimit; **Matematika, përmes analizave matematikore të të dhënave**; Shkencat e natyrës, përmes trajtimit të materialeve të dëmshme, si kimikalet gjatë punëve që bëjnë fëmijët në kopsht; Shëndeti dhe mirëqenia, përmes trajtimit të shëndetit fizik dhe emocional; Shoqëria dhe mjedisi, përmes analizës së konventave të fëmijëve; Jeta dhe puna, përmes trajtimit të rreziqeve në punë, pastaj përdorimi i teknologjisë elektronike për hulumtim dhe prezantim dhe gjithashtu rreziqet nga përdorimi i teknologjisë elektronike (Facebook-ut,...): Artet, përmes mesazheve vizuale (posterëve, pikturave, grafikave), por edhe auditve (instrumentaleve apo këngëve) e formave të tjera, duke organizuar ekspozita, koncerte etj

Si realizohet korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare?

Suksesi i gjithë zbatimit të KB-ve qëndron në trajtimin e integruar të temave mësimore nga kënde të ndryshme të fushave kurrikulare. Kjo iu mundëson nxënësve të kuptojnë funksionimin e jetës gjithnjë e më shumë të ndërlidhur.

Realizimi i korrelacionit bëhet në të gjitha planifikimet mësimore, p.sh. në planifikimin për shkallë, në mënyrë studiuëse bëjmë shpërndarjen e RNSH dhe RNF për secilën klasë. Në planifikimin vjetor përcaktojmë tema mësimore që janë në funksion të të gjitha lëndëve mësimore sa ka fusha kurrikulare. Gjithashtu, kërkohet që planifikimet vjetore të të gjithave fushave kurrikulare të vendosen në formatin e njëjtë, me qëllim të funksionimit të korrelacionit ndërmjet tyre. Në planifikimet dymujore vetëm kërkohet të shkruhet korrelacioni dhe kështu vijmë te planifikimi javor, i cili për qëllim ka pikërisht korrelacionin në mes fushave kurrikulare, përkatësisht lëndëve mësimore (shih më lart udhëzuesin, pjesën 3.5, Planifikimi javor) kjo ndërlidhje më pas reflektohet edhe në orën mësimore. Shih shembujt në vijim: p.sh. kl. VI

ZGJIDHJA E THYESAVE ME EMËRUES TË NDRYSHËM ME PROBLEME NGA PËRDITSHMËRIA	Merrin shembuj lidhur me temat mësimore nga fushat e tjera, p.sh Gjeografi -sipërfaqja e tokës e mbuluar me oqeanë. Apo nga fusha Shëndeti dhe mirëqenia ndarja e ushqimeve, po edhe nga fushat e tjera kurrikulare .
--	--

Për më shumë shih KKK dhe KB-të - fushën e Matematikës, çështjet ndërkurrikulare

Aktiviteti 1: Diskuto me kolegë të fushës së Matematikës dhe identifikoni disa çështje ndërkurrikulare, të cilat mund t'i trajtoni përmes matematikës dhe identifikoni RNSH-kompetencë në të cilat mund të kontribuoni.

Aktiviteti 2: Vrojtto planifikimin javor të përgatitur bashkërisht me kolegët e të gjitha lëndëve mësimore dhe identifikoni lëndët mësimore, respektivisht njësitë mësimore me të cilat mund t'i ndërlidhësh njësitë mësimore të cilat i ke planifikuar.

4. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, MATERIALET MËSIMORE, VLERËSIMI DHE INSTRUMENTET E TIJ

Metodologjia e mësimdhënies;

Materialet mësimore;


Metodologjia e vlerësimit;

Bashkëpunimi i mësimdhënësve.

4.1 Metodologjia e mësimdhënies në funksion të zbatimit të KKK-së-KB-ve

Pasi që kemi bërë planifikimin me kohë dhe të thuktë të KB-ve, duke e zbërthyer atë për nevojat dhe mundësitë e nxënësve, atëherë vetëm fillojmë realizimin praktik të tij. Kjo do të thotë se ne kemi bërë planifikimin për shkallë kurrikulare, planifikimin vjetor dhe dymujor të procesit mësimor, planifikimin javor dhe të orës mësimore, i kemi ndërlidhur në mënyrë logjike dhe kështu jemi gati për zbatim praktik brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj, si në realizimin e aktiviteteve brenda orës mësimore, në dhënien e detyrave të shtëpisë, e po ashtu edhe në aktivitetet jashtëkurrikulare. Në këtë rast, na mbetet vetëm të zbatojmë metodologjitë e mësimdhënies së planifikuar.

Për të zbatuar Kurrikulën Bërthamë mësimdhënësi duhet të jetë kreativ, që të lehtësojë dhe të përshtatë qëndrueshmërinë e të nxënësve. Prandaj, nuk ekziston një metodologji e veçantë e mësimdhënies. Mësimdhënësi duhet të aplikojë metoda, të cilat e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm të të nxënësve, metodologji që janë në funksion të arritjes së qëllimeve dhe mundësojnë përmbushjen e parimeve të KKK-së. Po ashtu, mundësojnë zhvillimin e RNSH - kompetencave dhe RF të KB-ve. Metodatat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Metodologjia e mësimdhënies dhe e nxënies është një rrugë, e cila përcakton se si do ta mbajmë një orë mësimore. Ato bazohen në këta komponentë:



Kjo ka për qëllim zbatimin e praktikave të të nxënit aktiv dhe të zgjidhjes së problemeve me qasje hulumtuese. Mësimdhënësi synon që me zbatimin e metodologjisë të motivojë nxënësit për punë të suksesshme, të nxitë kreativitetin për komunikim efektiv, të forcojë bashkëpunimin në mes të nxënësve dhe të ndihmojnë ata në hulumtimin e burimeve të ndryshme të informacionit. KKK-ja e Kosovës kërkon ndryshim në qasjen e mësimdhënies nga ligjërimi në lehtësim, gjë që sjell një sfidë të re për mësimdhënësit. Kjo ecje drejt lehtësimit të të nxënit të nxënësve është e rëndësishme për zotërimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive të shekullit 21. Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta⁴, ngase nxësin dinamikën e orës mësimore, thyjnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim. “Të nxënit e matematikës është sfidues, në mënyrë unike, çka do të thotë se ai është tepër i organizuar, me sekuenca dhe progresiv. Ka elemente më të thjeshta, të cilat duhet të mësohen para se të kalohet te të tjerat. Është një lëndë në të cilën secili mëson pjesët e më pas ato pjesë i shtohen njëra-tjetrës për të bërë tërësinë“. (Chinn dhe Ashcroft, 1988:4).

⁴ Shiko planifikimet mësimore në shtojcë. Aty janë paraqitur metoda dhe teknika të ndryshme të mësimdhënies, nxënies dhe të vlerësimit.

Motivimi është një prej burimeve më efektive, të cilat promovojnë rezultate të mira në të nxënit e nxënësve, që do të thotë se mësimdhënësit i duhet të hulumtojnë faktorët që krijojnë motivim, prandaj komunikimi me nxënës ka rëndësi të madhe. Le ta ilustrojmë këtë me një shembull:

*Mësuesi ka rreth 20 vjet që shpjegon se si zgjidhet një ekuacion i shkallës së dytë apo dhe më thjesht, një ekuacion i shkallës së parë apo konceptet e limitit, derivatit e integralit të funksionit dhe për të kjo është kthyer tashmë në një rutinë, madje dhe bezdi dhe ka harruar se sa kohë dhe vetë atij i është dashur që ato t'i qartësojë duke pasur në shumicën e rasteve parasysh se mësuesit e matematikës kanë pasur dhe një prirje të veçantë për lëndën. Nxënësit që ndeshen për herë të parë me njohuri e koncepte, shpesh abstrakte për ta, sigurisht që do t'u duhet kohë të familjarizohen dhe mësuesi nuk duhet të shqetësohet, nuk duhet t'i ngutë ata dhe aq më shumë nuk duhet t'i fyejë e demotivuar duke u shprehur „**Si nuk e zgjidhni këtë ushtrim, ky është fare i lehtë ! Ja shikoni sa shpejt e zgjidh unë**“. Ose duke ngritur shpesh nxënësin më të mirë të klasës u thotë „**Ja dhe shoku juaj X sa shpejt e zgjidhi ushtrimin ose problemin, bile dhe pa ndihmën time**“. Duke mos marrë në konsideratë këtu se nxënësi që ka ngritur para këtij të fundit mund të jetën me prirje të shkëlqyera në muzikë, histori, biologji, apo lëndë të tjera. Kjo mënyrë e të komunikuarit nuk bën gjë tjetër veçse frenon e dekurajon nxënësit me përparim jo të mirë apo të ngadaltë, të cilët ose e ndjekin procesin me vështirësi ose demoralizohen plotësisht. Në matematikë mund të ecet shpejt vetëm duke i përvetësuar njohuritë ngadalë, por qartë. Po që se njohuritë matematike mësohen shpejt, përmendësh e të paqarta, ato nuk do të harmonizohen natyrshëm me konceptet e njohuritë e tjera dhe do të harrohen ose do të jenë fragmentare dhe pa mundësi zbatimi në një të ardhme jo shumë të largët. (Mësuesi, numri 10 (2556) - nëntor 2010).*

Secila klasë në shkollë përbëhet nga nxënës të cilët kanë aftësi dhe prirje të ndryshme për të mësuar lëndët e caktuara. Dallimet e nxënësve në përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të ndryshme janë sidomos të shprehura në lëndën e matematikës. Numri i nxënësve me talent në matematikë është i kufizuar, një pjesë kanë aftësi mesatare dhe një numër i konsideruar i nxënësve kanë vështirësi në të mësuarit e matematikës. Kjo përbërje e klasës me nxënës me aftësi të ndryshme në të mësuarit e matematikës ia vështirëson punën mësimdhënësit. Një mësimdhënës i kujdesshëm i matematikës arrin të gjejë mënyra të përshtatshme për të ndihmuar zhvillimin e potencialit të të gjithë nxënësve për të përparuar në të mësuarit e matematikës. Një planifikim i kujdesshëm i orës mësimore ofron mundësi që mësimdhënësi:

- Të nxitë nxënësit e talentuar të zgjerojnë njohuritë në matematikë;
- Të përkrahë nxënësit me aftësi mesatare të zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në matematikë;
- Të ndihmojë nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë të bëjnë përparim gradual dhe të motivojnë ata për të shkuar më tutje me të mësuarit e matematikës.

Mësimdhënia, nxënia dhe vlerësimi janë komponentë që e plotësojnë njëri-tjetrën dhe nuk mund të jenë të ndarë. Mësimdhënësit mund ta përdorin vlerësimin për të identifikuar njohuritë dhe përvojat, të cilat nxënësit i sjellin në detyrat e tyre, në mënyrë që të planifikojë mësimdhënien, të rafinerojë programet mësimore për t'i plotësuar nevojat individuale dhe ato grupore. Mësimdhënësi jep mësim me një kuptueshmëri, duke përdorur materiale dhe burime mësimore, të cilave nxënësit mund t'u qasen përmes të shikuarit, të dëgjuarit, prekjes etj.

Si mund të përzgjidhet metodologjia e mësimdhënies në funksion të kompetencave?

Rezultatet e të nxënit për shkallë - kompetencë (RNSH) dhe rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF), përveçqë janë pika referuese të përzgjedhjes së përmbajtjes mësimore, temave mësimore, respektivisht njësive mësimore në planifikimet e procesit mësimor, ato na ndihmojnë edhe në përzgjedhjen e metodologjisë së mësimdhënies dhe të të nxënit konform filozofisë dhe parimeve të KKK-së. (shih më lart dokumentin në pjesën Parimet e arsimit parauniversitar, si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimorë dhe pjesën e planifikimeve - modelet e planifikimeve mësimore).

Shembull të përzgjedhjes së metodave dhe teknikave mësimore në funksion të rezultateve të kompetencave, respektivisht të parimeve të KKK-së në planin mësimor.

Planifikimi i orës mësimore

Fusha kurrikulare/Lënda: Matematikë

Shkalla e kurrikulës III / Klasa: VI-të

Kontributi në kompetencat kryesore për shkallën 3:

2. KOMPETENCA E TË MENDUARIT (MENDIMTAR KREATIV)

2.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor,..etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

3. KOMPETENCA E TË NXËNIT

3.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

4. KOMPETENCA PËR JETË PUNË DHE MJEDIS (KONTRIBUES PRODUKTIV)

4.7 Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statutit të tyre social, etnik, etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

6. KOMPETENCA QYTETARE (QYTETAR I PËRGJEGJSHËM)

6.1 Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që si përfillin ato, duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.

(Ju mund t'i shkruani RNSH e kompetencave vetëm me numra si në KB).

Rezultatet e fushës për shkallën 3, që synohet të realizohen:

1. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Përdor simbole, fakte, mjete dhe strategji adekuate për zgjidhje të problemeve që kanë të bëjnë me numra racionalë, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe matjen e formave 2D dhe 3D.

4. LIDHJET NË MATEMATIKË

Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike, në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme.

(Po ashtu, edhe RNF mund t'i shkruani vetëm me numra rendorë, si në KB).

Njësia mësimore: NUMRAT E THJESHTË DHE TË PËRBËRË (USHTRIME)

Mjetet e punës: Tabela, shkumësi, shpuza, tabela e numrave nga 1 deri në 100 të ndara në dhjetëshe, fletoret dhe lapsat e nxënësve.

Fjalët kyçe: Numra të thjeshtë, numra të përbërë.

Rezultatet e të nxënës RNL/orës – Nxënësi/ja:

- dallon numrat e thjeshtë nga numrat e përbërë;
- zbaton rregullat e plotpjesueshmërisë për caktimin e numrave të thjeshtë dhe numrave të përbërë për të gjetur këta numra në tabelën e numrave nga 1 deri në 100.

Kriteret e suksesit:

- Caktojmë numrat e thjeshtë dhe të përbërë të numrat nga 1 deri në 100

Pjesa e planifikuar⁵

<p>Pjesa hyrëse (10 minuta)</p> <p>Punohet në grupe</p> <p>Përdoret teknika “Shkrim i lirë”</p> <p>{Nxënësve u kërkohet të diskutojnë në grup e më pas shkruajnë për numrat e thjeshtë dhe të përbërë}. Kompetenca 4.7 Cilët numra janë të thjeshtë e cilët të përbërë.</p> <p>{Përdori teknikën “Lapsat në mes” për të përzgjedhë nxënësin që do të lexojë.}</p>	<p><u>Kontribuues produktiv</u></p>
---	--

Kompetenca 2.4- Mendimtar kreativ dhe Kompetenca 3.3 – Nxënës i suksesshëm

R. F. për SHK.3 – 1. Zgjidhja e problemeve dhe 4. Lidhjet në matematikë

<p>Pjesa kryesore (20 minuta)</p> <p>Aktiviteti: “Tabelave e numrave nga 1 deri në 100”</p> <p>Nxënësve në grupe iu jepet nga një fletë në të cilën janë shkruar numrat nga 1 deri në 100. Atyre iu kërkohet që të caktojnë numrat e thjeshtë duke zbatuar rregullat e plotpjesueshmërisë. T’iu përgjigjen pyetjeve në fletat e bëra, si:</p> <ul style="list-style-type: none">- Cila dhjetëshe ka më së shumti numra të thjeshtë?- Cila dhjetëshe ka më së shumti numra të përbërë?- A është e mundur që tre numra të njëpasnjëshëm të jenë të thjeshtë? (Ilustroje)- A është e mundur që tre numra të njëpasnjëshëm të jenë të përbërë?(Ilustroje) <p>Këto pyetje janë të shpërndara në grupe.</p> <p>Përgjigjet nxënësit i shënojnë njëherë në fletat e dhëna më pas edhe në fletoret e tyre.</p> <p>Grupeve iu merren fletat e plotësuar me përgjigjet dhe në to shkruhen emrat e nxënësve. Bëhet kontrollimi dhe vlerësimi i tyre.</p>	
<p>Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënës (10 minuta)</p> <p>Përdoren teknikat “Lapsat në mes” dhe “Shqyrtim i përbashkët” për të prezantuar punën e grupit. Përgjigjja e pyetjes së fundit shkruhet në tabelë. Këto përgjigje shkruhen edhe nga të gjithë nxënësit e klasës.</p> <p>Detyrë shtëpie: Shkruani 5 numra tre ose më shumëshifrorë të plotpjesëtueshëm me 3.</p>	

⁵ Me shigjeta janë sqaruar pjesët e orës mësimore të zhvilluara në klasë që kontribuojnë në zhvillimin e Kompetencave dhe RF.

Gjatë tërë orës është zhvilluar kompetenca 6.1 – Ovtetar i përgjegjshëm

Reflektim për orën e mbajtur:

Nxënësit kanë kuptuar dallimin ndërmjet numrave të thjeshtë dhe të përbërë. Disa kanë harruar të gjejnë numrat e përbërë të plotpjestueshëm me 3, por pas shqyrtimit të përbashkët i kanë kuptuar-përmirësuar gabimet e tyre.

Gjithashtu, duke i angazhuar të gjithë nxënësit respektohet **Parimi i gjithpërfshirjes**. Duke bërë vlerësimin transparent të nxënësve respektohet **Parimi i përgjegjësisë dhe llogaridhënies**.

Shih fotot e aktiviteteve që janë realizuar gjatë kësaj ore mësimore



Foto 3. Punë në grupe

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

Udhëzimi: duke zbatuar rregullat e plotpjestueshmërisë së pari eliminohet numrat që plotpjestohen me 2 në

Fig. 2, Numrat natyrorë nga 1 – 100

AKTIVITET:

Zgjidhni RNF dhe RNL për lëndën e matematikës për klasën e caktuar, përcaktoni temën/njësitë me të cilat mendoni se do të adresohen rezultatet e të nxënësve të orës mësimore (RNL) që keni zgjedhur. Përcaktoni strategjitë, teknikat, burimet me të cilët do të adresoni arritjen e rezultateve të planifikuara, ndiq shembullin më lart.

4.2. Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre), burimet mësimore


Planifikimet mësimore me qasje të re u mundësojnë mësimdhënësve të jenë autonomë në përzgjedhjen e përmbajtjes, metodologjisë së mësimdhënies dhe gjithashtu të materialeve mësimore.

Si ndihmojnë materialet mësimore në zhvillimin e kompetencave?

Mësimdhënësi mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të mësimdhënies, përzgjedh materiale mësimore që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuara dhe parimeve të KKK-së. Përzgjedhja adekuate e materialeve konform temës mësimore dhe potencialeve të nxënësve ndikon në stimulimin e progresit të tyre drejt zhvillimit të shprehive dhe shkathtësive të nevojshme për jetë dhe punë.


Sot, teksti mësimor nuk konsiderohet si burim i vetëm dhe i mjaftueshëm për zhvillimin e kompetencave të nxënësit, sepse nuk mund t'i përcjellë zhvillimet e shpejta që po ndodhin në fushat e ndryshme të jetës shoqërore dhe gjithashtu nuk është i përshtatshëm për gjithë nxënësit/et të së njëjtës moshë sa u përket niveleve të njohjes.

Kjo na bën me dije se mësimdhënësit duhet të sigurojnë edhe materiale të tjera mësimore për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave. Materialet mësimore nuk do të thotë të jenë domosdo të shtrenjta dhe të sofistikuara. Shumë aktivitete mësimore matematikore përpos me formularë, skica, figura, grafikone, diagrame, vegla mësimore, si trekëndëshi, këndmatësi, kompas, apo edhe vegla të tjera, mund të realizohen edhe me materiale të krijuara nga mësimdhënësit, por edhe nga vetë nxënësit. **Kujto të nxënit duke vepruar!** Krijimi i këtyre materialeve mund të bëhet edhe me materiale ricikluese, si letër, gazeta, rroba të vjetra, ambalazhe të ushqimeve, copëza të drurit, litarë, produkte ushqimore etj.,




respektivisht me gjëra të cilat mund t'i ketë çdo shtëpi dhe që nuk i përdor më. Gjithashtu, në disa raste mësimdhënësit së bashku me nxënës mund t'i riciklojnë edhe vetë.

Materialet mësimore lehtësojnë arritjen e rezultateve mësimore dhe përvetësimin e koncepteve matematikore. Përmes materialeve mësimore, nxënësit duke i përdorur dhe praktikuar në aktivitete ata mund të matin, llogarisin dhe zgjidhin probleme matematikore në favor të teorive dhe produkteve të rëndësishme për jetën e njeriut. Shih shembujt në foto. (Në foton e fundit shih një instrument se si shpjegohet **Teorema e Pitagorës**).



Burim mësimor është edhe interneti, i cili duhet të përdoret më shumë nga ana e mësimdhënëseve dhe nga ana e nxënësve. Ekzistojnë shumë faqe dhe programe aplikative kompjuterike matematikore falas që ndihmojnë në zhvillimin e rezultateve mësimore dhe përvetësimin e përmbajtjeve matematikore. Një prej tyre është Geogebra. Geogebra është program tejet i përpunuar dhe mund të përdoret si në shkollim fillor ashtu edhe në shkollim të mesëm dhe atë universitar. Shumë materiale mësimore janë në dispozicion falas. Për të parë sa e dobishme është Geogebra ju sugjerojmë të hyni në faqen <http://www.geogebra.org/?lang=en>.



Mësimdhënësi duke përdorur materiale dhe burime, të cilave nxënësit mund t'u qasen përmes të shikuarit, të dëgjuarit, prekjes, zhvillon te nxënësit shkathtësi dhe shprehje pune. Për t'i arritur këto përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, bën vizatime, modelime (*Kujto, çdo punim dore kërkon të menduarit matematik!*), jep ndihma të veçanta, adapton shembuj të ndryshëm dhe krijon ambient për aktivitete mësimore.



4.3. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Pjesa më e vështirë dhe më delikate e procesit mësimor është vlerësimi. **Vlerësimi** është i vështirë, sepse gjatë realizimit të tij mësimdhënësi duhet të shqyrtojë jo vetëm **përfitim**in e njohurive nga ana e nxënësve, por edhe shkallën e **zhvillimit të kompetencave** (rezultatet e të nxënësve për shkallë -**RNSH**) dhe realizimin e **rezultateve të fushës (RNF)** për shkallën - klasën e caktuar.

Ekzistojnë **lloje të ndryshme të vlerësimit** të nxënësve, të cilat mund t'i klasifikojmë në dy kategori të mëdha: **vlerësimi formativ** (bëhet gjatë tërë procesit mësimor në mënyrë vazhdueshme dhe identifikon anët e forta dhe vështirësitë në të nxënësve) dhe **vlerësimi sumativ** (vlerësimi përmblendhës organizohet pas një periudhe të caktuar kohore dhe na jep informacion të përgjithshëm mbi suksesin e nxënësve). Mësimdhënësit e matematikës, përveç mësimi përmblendhës, përdorin edhe vlerësimin formues, pasi natyra dinamike e zhvillimit të lëndës-fushës kryesisht është e bazuar në zgjidhjen e shembujve dhe detyrave të ndryshme dhe kjo ka bërë që mësimdhënësi në mënyrë të vazhdueshme të përcjellë përparimin e nxënësve. Ky vlerësim ka qenë rutinor gjatë orës mësimore.

Me Kurrikulën e re vlerësimi **duhet të jetë i planifikuar** në çdo **orë** mësimore, planifikim **javor, mujor e vjetor**, dhe duhet të përdoren mënyra të ndryshme të vlerësimit. Vlerësimi i organizuar mirë në klasë do të thotë një klasë aktive, cilësi në nxënie, efektivitet në mësimdhënie dhe motivim të shtuar të nxënësve. Përqendrimi gjatë procesit të vlerësimit vihet në zhvillimin e shkathtësive psikomotorike, shkathtësive komunikuese dhe në fushën emocionale.

Motivimi është njëri prej burimeve më efektive, të cilat promovojnë rezultate të mira në të nxënë dhe në vlerësim, që do të thotë se mësimdhënësit i duhet të hulumtojnë faktorët që

krijojnë motivim dhe si mund ta mbështetë vlerësimi motivimin apo të ketë efekt të kundërt. Mbi këtë bazë **mësimdhënësit mund ta përdorin vlerësimin** për të **identifikuar** njohuritë dhe përvojat, të cilat nxënësit i sjellin në detyrat e tyre, në mënyrë që të planifikojnë mësimdhënien, të **rafinerojnë** programet mësimore për t'i plotësuar nevojat individuale dhe ato grupore. Po ashtu, vlerësimi përdoret për të **monitoruar** progresin e nxënësve dhe për të zbuluar se çfarë lloj nxëniesh po ndodhin, d.m.th. se sa po përmbushen rezultatet mësimore të përcaktuara në kurrikulën e lëndës dhe se cilat janë vështirësitë në nxënie.

Në literaturat pedagogjike dhe në praktikat shkollore janë të njohura këto metoda të vlerësimit:

4.3.1 Metodat e vlerësimit

1. Detyrat individuale

Për të thelluar të kuptuarit e (njësisë) temës mësimore, zbatimin e njohurive, zgjidhjes së problemeve, arsyetimet, përfundimet, ndërlidhja me jetën reale dhe zhvillimi i shkathtësive të mësimdhënies dhe nxënies realizohet përmes detyrave individuale. Karakteristikë e kësaj metode është analizimi i kërkesave shtesë në librin e nxënësit, dokumentarë të ndryshëm dhe në krijimin e hartës së koncepteve.

2. Projektet individuale

Me këtë metodë të vlerësimit përfshihen zgjedhja dhe përdorimi i provave (dëshmime) për të identifikuar, përshkruar, analizuar dhe për të nxjerrë konkluzione në lidhje me çështjen apo problemin e veçantë. Duhet të përfshihen shumë shpesh nxënësit në një sërë aktiviteteve për një kohë të konsiderueshme, në mënyrë që të punojnë në mënyrë individuale. Nga mësimdhënësi kërkohet që të planifikojë strategjinë e mbështetjes në përqendrim në shkathtësi të mësimin. Për karakteristikë ka shfrytëzimin e burimeve sekondare – detyrat e planifikuara nga mësimdhënësi dhe burimet primare që përfshijnë grumbullimin e të dhënave nga provat, eksperiment, apo edhe nga terreni.

3. Projektet grupore

Me metodën e projekteve grupore zhvillohet përgjegjësia individuale, ndërvarësia sociale dhe zhvillimi i shkathtësive personale. Karakteristikë ka formën e organizimit të aktiviteteve, identifikimi i roleve të anëtarëve të grupit, produkti duhet shkruar.

4. Aktivitetet e vëzhgimit

Me këtë metodë bëhet grumbullimi i shënimeve në mënyrë sistematike dhe duke evidentuar saktë ngjarjen në kohën e duhur dhe në momentin e duhur, momentet shënohen për secilin nxënës. Realizohet përmes intervistës me secilin nxënës apo edhe grupor, ndërsa lista e kontrollit bazohet në komentet e mbledhura. Për karakteristikë ka shënimin dhe regjistrimin e komenteve në një faqe të veçantë për secilin nxënës.

5. **Prezantimet me gojë**

Është një nga metodat mjaft motivuese për vlerësim, e në veçanti ata të cilët nuk e preferojnë të shkruarit. Është tregues i fuqishëm i shkathtësisë së komunikimit, nxënësit prezantojnë raporte me gojë para audiencës, si mundësi të madhe për debate dhe diskutime.

6. **Të dëgjuarit**

Duhet që me kujdes të përgatiten pyetjet (kërkesat). Kjo zhvillon një spektër të gjerë shkathtësish (komunikimi, qëndrimet, vlerat dhe shkathtësia e koncentrimit dhe të dëgjuarit) bashkëpunimi në grup, përmbledhje të shkurtra. Karakterizohet me kohëzgjatjen e përkushtimit të vëmendjes, përshtatshmërisë dhe saktësisë së informatës.

7. **Libri i hapur**

Planifikohet me shumë kujdes dhe përdoret për të gjetur njësinë apo temën, jo për përgjigjen e pyetjeve në libër. Ka për karakteristikë përdorimin e referencave të ndryshme.

8. **Punimet praktike**

Jepen udhëzime dhe vërejtje të nevojshme në mënyrë që të zhvillohen kompetencat e caktuara. Niveli i njohjes së pasjeve dhe konkludimet e nxjerra nga matjet. Për karakteristikë i ka procedurat që duhet përvetësuar.

9. **Aktivitetet kreative**

Duhet të bëhet një numër i ushtrimeve për matjen e të kuptuarit të koncepteve, shfaqet niveli i kompetencave, bëhet punë individuale dhe grupore. Për karakteristikë i ka stimulimin, intervistat, debatet.

10. **Testet dhe detyrat kontrolluese**

Janë shumë motivuese për disa nxënës, në veçanti që kanë dëshirë shkrimin, në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme bëhet vlerësimi i arritjeve të nxënësve, janë të lehta për t'i organizuar dhe të vështira për korrigjime. Mundësi e madhe në përfshirjen e nxënësve në riorganizimin e argumenteve fakteve dhe ideve për të përmirësuar efektivitetin e nxënies. Përdorimi i referencave të ndryshme. Karakteristikë e saj është se bëhen teste individuale dhe grupore, me kohëzgjatje të kufizuar.

Shih më poshtë **një instrument**, i cili mund të jetë në funksion të këtyre metodave të vlerësimit.

Listë kontrolli

Aktivitetet	Nivelet e performancës			Sugjerime për përmirësim
	Jo i kënaqshëm	I kënaqshëm	I arritur	
Detyra individuale				
Projekte individuale				
Projekte grupore				
Prezantim me gojë				
Të dëgjuarit				
Përdorimi i librit				
Aktivitete kreative				
Teste dhe detyra kontrolluese				

Për secilin aktivitet mund t'i përshkruani llojin e performancës konform niveleve të performacës .

Emri i nxënësit: Kl:..... Mësimdhënësi-ja:

Ky instrument mund të përdoret për periudha të ndryshme kohore gjatë vitit mësimor.

4.3.2 Sistemi i vlerësimit të nxënësve

Gjatë procesit të vlerësimit, vlerësohet progresi i vazhdueshëm dhe niveli i arritshmërisë së rezultateve të nxënësit të përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë dhe programet e fushës së kurrikulës, e në këtë rast fushës së Matematikës. Procesi i vlerësimit sipas KKK-së orientohet në vlerësim të brendshëm dhe në vlerësim të jashtëm. Ne kryesisht do të fokusohemi në vlerësimin e brendshëm, sepse është një risi për shkollat tona.

1. Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm duhet t'u mundësojë të gjithë nxënësve të shprehin nivelin e zotërimit të dijeve, zhvillimit të shkathtësive dhe formimit të qëndrimeve të tyre me anë të detyrave dhe kërkesave që kanë nivele të ndryshme të kompleksitetit, përfshirë:

- Gjerësinë dhe thellësinë e të nxënësit të përvetësuar;
- Gatishmërinë për t'u përgjigjur sfidave të nivelit të përcaktuar me rezultatet e të nxënësit dhe për të ecur drejt të nxënësit edhe më sfidues;
- Aftësinë për të zbatuar të nxënësit në situata ndryshme dhe rrethana të reja.

Zbatimi i vlerësimit bazuar në kompetencat e përcaktuara me Kornizën e Kurrikulës do t'u mundësojë mësimdhënësve dhe shkollës që të jenë të saktë dhe të besueshëm në vlerësimin e arritjeve të nxënësve në të gjitha shkallët e shkollimit të tyre. Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel klase dhe në nivel shkolle (vlerësimi në nivel shkolle mund të bëhet edhe nga jashtë).

1.1 Vlerësimi i nxënësit në nivel klase

Qëllimet e vlerësimit të nxënësve në nivel klase janë si vijon:

- Vlerësimi i arritshmërisë;
- Identifikimi i afiniteteve/prirjeve të nxënësve;
- Planifikimi i punës së mëtejme me nxënës.

Vlerësimi në nivel klase përfshin **vlerësimin e vazhdueshëm** gjatë gjithë vitit shkollor. Ky vlerësim bëhet konform rezultateve të planifikuara që duhet të arrihen nga secili nxënës për kompetenca (RNSH) dhe për fushë (RNF), siç janë paraparë në planifikime, si dymujore, javore dhe të orës mësimore; **vlerësimin përfundimtar** (me rastin e përfundimit të vitit shkollor), konform planifikimit vjetor-dymujore dhe **vlerësimin përmbyllës** (me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës) që merr për bazë RNF dhe RNSH e planifikimit për shkallë respektivisht sipas KB-ve të nivelit të caktuar.

1.1.1 Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve, përveç formave të ndryshme joformale gjatë gjithë procesit mësimor, bëhet përmes shkallës së vlerësimit që përfshin notat nga 1- 5.

Nota 1: performancë e pamjaftueshme në realizimin e detyrës së dhënë;

Nota 2: performancë e mjaftueshme në realizimin e detyrës së dhënë;

Nota 3: performancë e mirë në realizimin e detyrës së dhënë;

Nota 4: performancë e shumë e mirë dhe e kompletuar në realizimin e detyrës së dhënë;

Nota 5: performancë e shkëlqyeshme dhe origjinale në realizimin e detyrës së dhënë.

Kjo shkallë vlerësimi përdoret për të vlerësuar çdo situatë në të cilën nxënësi sfidohet për të realizuar një detyrë të caktuar nga mësimdhënësi dhe evidentohet në ditar apo/dhe në regjistrat përkatës të mësimdhënësit. Referencë kryesore për vlerësimin për nxënie dhe llojeve të tjera të vlerësimit janë rezultatet specifike të të nxënësve të përcaktuara në kuadër të programeve shkollore.

Vlerësimi për zgjidhjen e problemeve

Nota (5) Nxënësi zgjidh problemet shpejt, në mënyrë të pavarur, saktë dhe argumentuese. Miraton dhe përdorimin e koncepteve të reja. (Për të gjitha rezultatet e fushës/lëndës).

Vlerësimi me gojë: Nxënësi përgjigjet shpejt, i pavarur dhe me saktësi i zgjidh të gjitha detyrat dhe kërkesat më komplekse.

Vlerësimi me shkrim: Nxënësi arrin (90 – 100) % të pikëve të përcaktuara.

Aktivitetet: Nxënësi është aktiv, i vëmendshëm, i motivuar, gjithmonë për të gjetur një zgjidhje, të plotë, nuk do të heqë dorë nga rezultati.

Detyrat e shtëpisë: Nxënësi është shembullor, i plotë, i rregullt dhe të gjitha detyrat i zgjidh me saktësi.

Nota (4) Nxënësi i zgjidh problemet me një shpejtësi të moderuar, saktë dhe pa ndihmë nga mësuesi. Përvetëson shpejt konceptet e reja .

Vlerësimi me gojë, në tabelë: Nxënësi përgjigjet me një shpejt të moderuar, i pavarur dhe me saktësi i zgjidh pothuajse të gjitha detyrat dhe kërkesat më komplekse.

Vlerësimi me shkrim: Nxënësi arrin (80 - 90) % të pikëve të përcaktuara.

Aktivitetet: Nxënësi është aktiv, i suksesshëm në shpjegime është i plotë dhe shumë i interesuar për të gjetur zgjidhjen.

Detyrat e shtëpisë: Nxënësi është shumë e mirë, detyrat i zgjidh rregullisht me korrektësi, me pakë gabime.

Nota (3) Nxënësi, me pakë ndihmë, i zgjidh problemet ngadalë dhe i përvetëson konceptet e reja.

Vlerësimi me gojë, në tabelë: Nxënësi ngadalë përgjigjet, është i varur nga mësuesi apo nga shokët e grupit, problemet i zgjidh me gabime, përgjigjet në detyrat dhe kërkesat standarde të klasës.

Vlerësimi me shkrim: Nxënësi arrin (60 - 80) % të pikëve të përcaktuara.

Aktivitetet: Nxënësi është pjesërisht aktiv, shpjegimet i bën të pjesshme dhe është i interesuar për të gjetur zgjidhjen.

Detyrat e shtëpisë: Nxënësi është i mirë, detyrat i zgjidh rregullisht por me gabime.

Nota (2) Nxënësi me ndihmë të madhe i zgjidh problemet dhe ngadalë i përvetëson konceptet e reja.

Vlerësimi me gojë, në tabelë : Nxënësi shumë ngadalë përgjigjet, është i varur shumë nga mësuesi apo nga shokët e grupit, problemet i zgjidh me plot gabime, përgjigjet në detyrat elementare të zgjidhura në klasë.

Vlerësimi me shkrim: Nxënësi arrin (40 - 60) % të pikëve të përcaktuara.

Aktivitetet: Nxënësi nuk është aktiv me vështirësi e mban vëmendjen, shpjegimet i bën me vështirësi dhe fare pak është i interesuar për të gjetur zgjidhjen.

Detyrat e shtëpisë: Nxënësi është i mjaftueshëm, detyrat i zgjidh rrallë edhe me gabime.

Nota (1) Nxënësi nuk është në gjendje t'i zgjidhë problemet dhe fare nuk i përvetëson konceptet e reja.

Vlerësimi me gojë, në tabelë: Nxënësi fare nuk jep përgjigje dhe ato që i jep janë me gabime.

Vlerësimi me shkrim: Nxënësi arrin (0 - 40) % të pikëve të përcaktuara.

Aktivitetet: Nxënësi nuk është fare aktiv nuk e mbanë fare vëmendjen.

Detyrat e shtëpisë: Nxënësi nuk i zgjidh fare detyrat.

Kjo shkallë vlerësimi përdoret për të vlerësuar çdo situatë në të cilën nxënësi sfidohet për të realizuar një detyrë të caktuar nga mësimdhënësi dhe evidentohet në ditar apo/dhe në regjistrat përkatës të mësimdhënësit/shkollës. Referencë kryesore për vlerësimin për nxënie dhe lloje të tjera të vlerësimit janë rezultatet specifike të të nxënit, të përcaktuara në kuadër të programeve shkollore.

1.1.2 Vlerësimi përfundimtar bëhet në fund të çdo viti shkollor dhe reflekton nivelin e performancës së nxënësit gjatë një viti shkollor. Korniza e Kurrikulës së Kosovës rekomandon qasjen e vendosjes graduale të notës përfundimtare vjetore. Vendosja e notës bazohet në harmoni me të gjitha elementet e vlerësimit. Kryesisht raporti i elementeve të vlerësimit është:

- Me shkrim - testi (50% i notës);
- Veprimtaritë/sjellja në klasë (30% e notës);
- Punimet e nxënësit (10% e notës);
- Detyrat e shtëpisë (10% e notës).

Përshkrimi i shkallës së notimit të përfundimtar është si vijon:

Nota D: mesatarja e performancës gjatë vitit në nivel të shkallës së vlerësimit 2 (2.00 – 2.49);

Nota C: mesatarja e performancës gjatë vitit në nivel të shkallës së vlerësimit 3 (2.50 – 3.49);

Nota B: mesatarja e performancës gjatë vitit në nivel të shkallës së vlerësimit 4 (3.50 - 4.49);

Nota A: mesatarja e performancës gjatë vitit në nivel të shkallës së vlerësimit 5 (4.50 – 5.00).

Në fund të vitit shkollor, i cili shënon edhe përfundimin e një shkalle të kurrikulës (klasa II, V, VII, IX, XI dhe XII), përveç vlerësimit përfundimtar, bëhet edhe vlerësimi përmbyllës.

1.1.3 Vlerësimi përmbyllës

Me rastin e **vlerësimit përmbyllës** nuk nxirret mesatarja aritmetike nga notat e regjistruara në ditar gjatë periudhës që mbulohet me shkallën përkatëse të kurrikulës, por vlerësimi i nxënësit bëhet në bazë të listës së rezultateve të të nxënit për fushat mësimore të përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë (shih rezultatet e të nxënit sipas fushave mësimore në tabelën e sistemit të rezultateve të të nxënit).

Me këtë rast, për secilin nxënës evidentohet niveli i arritshmërisë së çdo rezultati të paraparë të të nxënit në kuadër të një fushe mësimore. Vlerësimi i arritshmërisë për secilin rezultat bëhet në bazë të shkallës së vlerësimit 1-5. Ky vlerësim bëhet nga ekipi i mësimdhënësve, të cilët kanë mbuluar aspekte të ndryshme të fushës përkatëse mësimore. Nota përmbyllëse për fushën përkatëse me rastin e përfundimit të një shkalle të kurrikulës

(nota përfundimtare A, B, C dhe D) nxirret nga mesatarja aritmetike e vlerësimit të arritjes së rezultateve të të nxënësve.

Sqarim

Për secilin shkallë të kurrikulës bëhet vlerësimi përmbyllës. Ky vlerësim bëhet duke u bazuar në rezultatet e shkallës për fushën/lëndën përkatëse, në kuadër të cilës hartohen kërkesa (pyetje) për instrumentin për matje. Sigurisht, secila kërkesë (e hapur apo e mbyllur) ka kompleksitetin dhe vështirësinë, andaj instrumenti për matje duhet bazuar në Taksonomi dhe të ketë shtrirje normale të kërkesave (hartimi i testit). Kryesisht kërkesat duhet të jenë divergjente.

Nxënësit që kanë arritur nivelin A, B, C, D vazhdojnë në klasën/shkallën vijuese. Nxënësit që kanë arritur nivelin D vazhdojnë në klasën/shkallën vijuese me programe shtesë në fushat/lëndët/modulet në të cilat performanca e tyre ka qenë nën shkallën e vlerësimit 2. Ata të cilët edhe me këtë rast nuk e arrijnë nivelin D përsërisin vitin shkollor.

Në librezën e nxënësit dhe në diplomën që lëshohet me rastin e përfundimit të një niveli të shkollimit regjistrohen vetëm notat përmbyllëse dhe rezultatet e vlerësimeve të standardizuara.

2. Vlerësimi në nivel shkolle

Vlerësimi në nivel shkolle i referohet nivelit të arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e gjashtë kompetencave kryesore, të shprehura në kuadër të Kurrikulës Bërthamë, përmes rezultateve esenciale të të nxënësve me rastin e përfundimit të çdo shkalle të kurrikulës.

Rezultati i arritur evidentohet në librezën shkollore të nxënësit dhe po ashtu në dëftesën e lëshuar në fund të nivelit formal.

Ky vlerësim organizohet nga vetë shkolla, me qëllim të vetëvlerësimit të cilësisë së procesit edukativo-arsimor që ofrohet në nivel të shkollës, si dhe me qëllim të planifikimit të masave për të siguruar nivelin e domosdoshëm të zotërimit të gjashtë kompetencave kryesore nga të gjithë nxënësit.

Vlerësimi i arritshmërisë së rezultateve të të nxënësve shkallë (RNSH) (shih rezultatet e të nxënësve sipas shkallëve të kurrikulës në KB) bëhet për secilin nxënës nga ekipi i mësimdhënësve që kanë punuar gjatë periudhës që mbulohet me vlerësim. Të dhënat e përpunuara në nivel shkolle, përfshirë edhe masat e planifikuara për modalitetet e punës plotësuese me nxënës, dorëzohen tek autoriteti komunal i arsimit. (Ky vlerësim mund të jetë edhe i jashtëm).

4.3.3 Dimensionet e performancës për raportim

Zhvilluesit e përshkruesve të niveleve të performancës janë të dobishëm, sepse ato përqendrohen në përshkrimin të asaj se si nxënësit i kanë arritur standardet sipas dimensioneve: komunikimi, zgjidhja e problemeve, shfrytëzimi i TIK-ut, shtrirja, shpeshësia, ndihma/facilitimi, thellësia, kreativiteti dhe cilësia e njohurive, aftësive dhe shkathtësive që ata i kanë fituar.

– **Komunikimi:** i referohet komunikimit të dijes dhe aftësive të fituara brenda fushës së kurrikulës tek të tjerët, përfshirë këtu nxënësit dhe mësimitdhënësit;

– **Zgjidhja e problemeve:** i referohet zgjidhjes së problemeve rutinore dhe të reja, të thjeshta dhe komplekse brenda fushës së kurrikulës;

– **Përdorimi i TIK-ut:** i referohet përdorimit të kompjuterëve dhe teknologjisë tjetër informative brenda fushës së kurrikulës;

– **Shtrirja:** i referohet shtrirjes së të kuptuarit e rezultateve të të nxënësve të kurrikulës që janë zotëruar dhe cili është niveli i arritjes së rezultateve të të nxënësve për shkallë /fushë;

– **Shpeshësia:** i referohet sa shpesh nxënësi demonstroi mjeshtëri gjatë procesit mësimor dhe sa shpesh nxënësi është në gjendje të demonstrojë zotërimin e një kompetence;

– **Ndihma/facilitimi:** i referohet nivelit të njohurive, aftësisë, shkathtësive dhe qëndrimeve, apo dhuntive që posedon dhe tregon një nxënës. Nxënësi është i qartë për atë që e thotë apo e demonstroi, duke arsyetuar, andaj klasifikohet si një person që të tjerët mund të mësojnë nga ai, apo ai u ndihmon të tjerëve;

– **Thellësia:** i referohet thellësisë që nxënësi i ka përmbushur rezultatet e të nxënësve përmes niveleve të dijes;

– **Kreativiteti:** i referohet aftësisë së nxënësve për të shkuar përtej asaj që është mësuar. Në termin “produkt” është aftësia për të krijuar diçka të re, përmes frymëzimit, imagjinatës, vizionit, inspirimit dhe zgjidhjes së problemit në situata të reja;

– **Cilësia:** i referohet njohurive dhe aftësive për të parë të mësuarit e nxënësve dhe përfshin identifikimin dhe tiparet kryesore të të mësuarit të nxënësve dhe se mësimi klasifikohet sipas shkallëve të përsosshmërisë dhe vlerave.

Tabela e mëposhtme (instrumenti) tregon disa nga termat që mund të përdoren në një sistem të performancës në nivel të klasifikuar të të mësuarit të nxënësve në përputhje me secilin nga dimensionet.

Listë kontrolli

DIMENSIONI	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
Komunikimi	Pasiv	Me vështirësi	Sipërfaqësisht	Me lehtësi	Rrjedhshëm
Zgjidhja e problemeve	Asnjë element	Të thjeshta	Të zakonshme	Mesatar	Kompleks
Shfrytëzimi i TIK-ut	Asnjë element	I varfër	I mirë	Shumë mirë	I avancuar
Shtrirja	Aspak	Ngushtë	Pjesërisht	Plotësisht	Zgjeruar
Shpeshtësia	Asnjëherë	Rrallë	Nganjëherë	Zakonisht	Përherë
Fasilitimi	Asnjë element	Ngadalë	Në mëdyshje	Shpejt	Automatikisht
Thellësia	Asnjë element	Sipërfaqësisht	Cekët	Thellë	Thellësisht
Kreativiteti	Pasiv	Imitues	I zakonshëm	Imagjinues	Krijues
Cilësia	Dobët	Varfër	Mangët	Sh. mirë	Shkëlqyeshëm

Emri i nxënësit:..... Klasa..... Emri i mësimitdhënësit-es:.....

4.3.4 Vlerësimi efektiv



Çfarë duhet bërë që vlerësimi të jetë efektiv?

Duke u nisur nga të kuptuarit praktik të konceptit të vlerësimit, mësimdhënësi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve së pari duhet të caktojë qëllimin i vlerësimit, apo duhet bërë vetes pyetjen pse po dëshiroj të vlerësoj? P.sh. po vlerësoj për të planifikuar, po vlerësoj për të

konstatuar nivelin e progresit të arritjeve të kompetencave, apo rezultateve të fushave kurrikulare, lëndës mësimore, njohuritë akademike të nxënësve, po vlerësoj për të përmirësuar mësimdhënien, po i vlerësoj përvojat e nxënësve, mënyrën e të nxënit (stilet) etj. Vlerësimi çdoherë duhet jetë i planifikuar me kohë, e ndoshta të bëhet edhe pjesë përbërëse e planifikimeve mësimore (shih planifikimin dymujor dhe të orës mësimore – kriteret e suksesit).

Cilat procedura mund t'i ndjekim që të matim progresin në arritjen e rezultateve të kompetencave?

Nëse dëshirojmë të matim progresin në arritjen e kompetencave, preferohet të ndjekim këtë procedurë:

- Së pari, për fushën e caktuar kurrikulare (matematikë) përcaktojmë se cilat rezultate të kompetencave të planifikuara në planifikime mësimore do t'i matim;
- Përcaktojmë nivelin e arritjes të kompetencës për moshën e nxënësve, sepse këto rezultate, siç e dimë, duhet të arrihen deri në fund të shkallës, prandaj edhe duhet zbrërthyer për klasë (kujto zbrërthimin e rezultateve të kompetencave për klasë! Shih pjesën e udhëzuesit, kur flitet për rezultatet e të nxënit për shkallë –kompetencë /RNSH dhe arritshmëria e tyre);
- Caktohet tema apo njësia mësimore përmes së cilës matim rezultatin e kompetencës;
- Dhe, në fund, caktohen metoda, teknika dhe instrumenti adekuat, përmes të cilit matet rezultati i kompetencës (RNSH). Kujdes! Rezultatet e kompetencave nuk janë vetëm njohuri, por edhe shkathhtësi, qëndrime, vlera dhe rutina. Shih KB-në fushat kurrikulare, pjesën e vlerësimit.

Si mund të bëhet vlerësimi i arritjeve të rezultateve të të nxënit përmes njësive mësimore?

Pasi keni përzgjedhur njësinë mësimore që do të zhvilloni në ditët në vijim, hartoni një plan vlerësimi për këtë njësi. Përcaktoni rezultatet e të nxënit lëndës/orës mësimore (mund t'i merrni nga plani dymujor) mbi bazën e RNSH-ve dhe RNF-ve (RNL), zgjidhni

një teknikë të vlerësimit dhe caktoni kriteret e suksesit (kujto planifikimin e orës mësimore). Shembull i një modeli të një plani të vlerësimit për një njësi mësimore.

<p>Fusha e kurrikulës /Lënda: Matematikë</p> <p><u>Njësia mësimore:</u> Matja e kohës</p> <p>Detyra kryesore me nxënës: Në grupe, kryejnë detyrën e matjes së kohës me njësi matëse adekuate, duke i zbërthyer ato në njëra-tjetrën.</p> <p>Metoda e vlerësimit: Vëzhgimi</p> <p>Instrument: Tabela vlerësuese e mësimdhënësit (mund të jetë listë kontrolli)</p> <p>Dëshmia: Identifikimi i përbashkët i grupit se cili është nxënësi më i ri dhe më i vjetri i klasës, dhe llogaritja i dallimeve në ditë e orë.</p> <p>Rezultatet e të nxënit - Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Shpreh njësitë matëse të kohës nga njëra në tjetrën, p.sh minutat në sekonda; ➤ Zgjidh probleme nga jeta e përditshme që kanë të bëjnë me matje të kohës. <p>Kriteret e suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Matim kohën me njësitë matëse adekuate; ➤ Shprehim njësitë matëse të kohës nga njëra në tjetrën, p.sh. minutat në sekonda 			
Tabela vlerësuese nga mësimdhënësi			
Kriteret e zbërthyer	Ka nevojë për përmirësim	I realizuar	Nivel i lartë
Njësitë matëse adekuate të kohës	Nxënësi nuk mat kohën me njësi adekuate matëse.	Nxënësi me vështirësi identifikon njësitë adekuate matëse të kohës.	Nxënësi mat kohën me njësi adekuate matëse.
Zbërthimi i njësive matëse të kohës	Nuk zbërthen njësitë matëse të kohës në njëra-tjetrën.	Zbërthen disa njësi matëse të kohës në njëra-tjetrën.	Zbërthen të gjitha njësitë matëse të kohës, siç është kërkuar.
Puna në grup	Nuk shpreh interesim të angazhohet në zgjidhjen e detyrës së grupit.	Orvatet të bashkëpunojë në zgjidhjen e detyrës së grupit.	Bashkëpunon në zgjidhjen e detyrës së grupit.

Mund të caktoni nivele të ndryshme vlerësuese, dy, tri e më shumë nivele, ndoshta deri në pesë nivele. Tabela vlerësuese përdoret për vlerësimin e secilit nxënësi.

4.4 Bashkëpunimi i mësimeve, si domosdoshmëri për zbatim të Kurrikulës së re

Çelësi i suksesit të nxënësve qëndron në bashkëpunimin kolegjial të mësimeve. Kjo do të thotë që në mes të mësimeve nuk duhet të ketë rivalitet negativ, sepse të gjithë synojnë zhvillimin maksimal të potencialeve të nxënësve; nuk duhet të ketë hezitim ndaj njëri-tjetrit, sepse të gjithë janë përgatitur për përkrahje të nxënësve; nuk duhet të hezitohet të kërkohet ndihmë nga njëri-tjetri për të ngritur profesionalizmin dhe performancën, sepse kjo bëhet për të mirën e nxënësve. **Mos harroni, transparenca eliminon çdo vështirësi!**

Zbatimi i filozofisë së KKK-së domosdo kërkon bashkëpunim ndërmjet mësimeve. Bashkëpunimi duhet të bëhet në nivel të Këshillit të klasës-klasave, por edhe të aktiveve profesionale.

Mësimeve të klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet bashkëpunojnë ndërmjet vete, por edhe me mësimeve të tjera dhe të fushave të ndryshme kurrikulare. Ky bashkëpunimi duhet të reflektohet në planifikime mësimore, që do të thotë se mësimeve-et e klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet bashkërisht të hartojnë planifikimet për shkallë dhe planifikimet vjetore, për të vazhduar më pas në shkëmbimin e ideve dhe përvojave në hartimin e planifikimeve dymujore, të cilat mund të jenë edhe të ndryshme nga mësimeve të ndryshme. Gjithashtu, mësimeve-et duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin në edhe planifikimet javore, edhe pse ata-ato janë përgjegjëse vetëm për një paralele.



Bashkëpunimin i mësimeve duhet të reflektohet edhe në shkëmbimin e përvojave të metodologjisë së mësimit, të vlerësimit, në krijimin dhe shkëmbimin e materialeve mësimore.



Mësimeve mund të marrin iniciativa për ngritje profesionale brenda shkollës, duke mbajtur vetë punëtori për çështje të ndryshme që janë në funksion të mësimit.

Mësimdhënësit bashkërisht mund t'i përgatisin nxënësit edhe për gara të ndryshme, për kuize diturie, gara sportive, ekspozita dhe aktivitete të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe në arritjen e kompetencave të caktuara.

Gjithashtu, suksesin e zbatimit të KKK-së e forcon edhe bashkëpunimi me mësimdhënësit e shkollave të tjera, duke shkëmbyer përvoja, literaturë, linçe interneti, informata, e njohuri të marra nga trajnimet e ndryshme.

Zbatimi me sukses i filozofisë së KKK-së së re, i bazuar në kompetenca dhe në RNSH + RNF, është tejet i vështirë pa integrimin e dijeve, shkathësive dhe mjeteve të përbashkëta ndër mësimdhënës në shkollë. Procesi matematikor nuk do të kuptohet nga nxënësit nëse për të nuk bashkohen dijet nga shkencat e natyrës (biologji, kimi, fizike) e fushat e tjera kurrikulare. Kjo shton domosdonë e bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve të fushave të ndryshme brenda një shkolle.

SHTOJCA

Modele të planifikimeve të mësimdhënësve të shkollave pilot dhe materiale të mësimdhënies dhe të vlerësimit të përdorura nga ta.

Ato mund të jenë të ndryshme nga shkolla në shkollë.

Shtojca 1 : Disa folje vepruese për hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit

Gjetja e fjalëve të duhura për hartimin e rezultateve të të nxënit/kritereve të vlerësimit mund të jetë e vështirë, veçanërisht kur fjalitë duhet të përputhen me nivelin e përgjithshëm të përshkrimit. Lista në vijim mund të përdoret për t'ju ndihmuar në këtë proces. Fjalët janë të organizuara në nëntituj që korrespondojnë me astronominë e Bloom-it. Megjithatë, kjo renditje nuk paraqet kurrfarë hierarkie. Fjalët përbëjnë thjesht një listë të vokabularit të vjelë nga burime të ndryshme për t'ju ndihmuar në hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit.

Foljet që kërkojnë fakte për njohuritë: Defino, përshkruaj, identifiko, emëro, listo, riprodho, përsërit, përzgjedh, deklaro, prezanto, ji i vetëdijshëm, nxjerr, organizo, rinumëro, shkruaj, prano, mat, nënvizo, ndërlihdh, bashko.

Foljet që kërkojnë fakte për të kuptuarit: Interpretu, përkthe, llogarit, arsyeto, shpreh, konverto, qartëso, mbro, dallo, shpjego, zgjero, gjeneralizo, ilustru, ofro shembuj, parafrazo, parashiko, rishkruaj, përmbledh, diskuto, përformo, raporto, prezanto, identifiko, trego, gjej, përzgjedh, kupto, përfaqëso, emëro, formulo, gjyko, krahaso, klasifiko, shpreh.

Foljet që kërkojnë fakte për të njohuri/kuptuarit: Apliko, zgjidh, ndërto, demonstro, ndrysho, llogarit, zbulu, manipululo, modifiko, opero, parashiko, përgatit, prodho, ndërlihdh, trego, përdor, jep shembuj, hartu, përzgjedh, shpjego, gjej, vlerëso, ushtr, ilustru, verifiko.

Foljet që kërkojnë fakte për analizë: Prano, dallo, vlerëso, analizo, zbërthe, diferenco, identifiko, ilustru, përshkruaj, përmend, ndërlihdh, përzgjedh, ndaj, nëndaj, krahaso, justifiko, zgjidh, ekzamino, përmbledh, kritiko, kontesto, diagnostiko, identifiko, kategorizo, shpjego.

Foljet që kërkojnë fakte për sintezë: Propozu, prezanto, ndërto, integro, formulo, mëso, zhvillo, kombino, kompoz, krijo, ndaj, dizajno, shpjego, gjenero, modifiko, organizo, planifiko, riaranzho, rindërto, ndërlihdh, riorganizo, rishiko, shkruaj, përmbledh, trego, raporto, ndrysho, argumento, rendit, përzgjedh, menaxho, gjeneralizo, nxjerr, përfundo, shkakto, sintetizo, sugjero, zgjero.

Foljet që kërkojnë evidencë për vlerësim: Gjyko, vlerëso, përmbledh, krahaso, përshkruaj si, kritiko, shpërndaj, arsyeto, mbro, grado, përcakto, zgjedh, çmo, kontesto.

Gosling, D. & Moon, J. (2002) How to use Learning Outcomes 6 Assessment Criteria - Learning Development Unit, London Metropolitan University. UK.

Krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës së Kurrikulës Bërthamë (KB), Shkalla 2, Fusha e Matematikës

Rezultatet e të nxënësve të fushës (RNF) Matematikë, marrë nga KB	Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të matematikës që korrespondojnë me RNF		Rezultatet pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e matematikës		Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e matematikës (RNL)	
	Lënda	Klasat		Klasat		Klasat
Nxënësi/ja:	E gjashtë	E shtatë	E gjashtë	E shtatë	E gjashtë	E shtatë
Nxënësi/ja: HAPI I PARË	Matematikë	Nxënësi/ja: HAPI I DYTË	Nxënësi/ja: HAPI I TRETË	Nxënësi/ja:	Nxënësi/ja:	Nxënësi/ja:
						HAPI I KATËRT

Udhëzime për plotësimin e tabelës:

Krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës së Kurrikulës Bërthamë (KB)

Për plotësimin e kësaj tablele duhet të ndiqni disa hapa. Të njëjtat sugjerime vlejné për çdo lëndë dhe për çdo klasë.

Hapi i parë

Në kolonën e parë të tabelës, me emërtim **Rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Matematikë, marrë nga KB**, duhet të vendosen rezultatet origjinale (ashtu siç janë) të të nxënit të fushës kurrikulare, të cilat mund t'i merrni në dokumentin e Kurrikulës Bërthamë për shkallën e caktuar. Këto rezultate janë të vlefshme për të gjitha lëndët, të cilat i përkasin fushës së kurrikulës për shkallën dhe klasën e caktuar.

Hapi i dytë

Në kolonën (kolonat) e tabelës, ku janë klasat dhe përmbi to është emërtimi **Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të matematikës që korrespondojnë me RNF**, në secilën klasë, duhet të vendosni rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese. Këto rezultate të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese që i vendosni në këto kolona duhet të jenë vetëm ato që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) dhe duhet të jenë origjinale, ashtu siç janë në plan dhe program.

Hapi i tretë

Në kolonën (kolonat) e tabelës, ku janë klasat dhe përmbi to është emërtimi **Rezultatet pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e matematikës (kujto planifikimet dymujore)**, duhet të vendosen rezultatet e pritshme, që ju mendoni se duhet të shtohen, meqenëse rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese nuk i përmbushin mjaftueshëm rezultatet e të nxënit të fushës (RNF).

Hapi i katërt

Në kolonën (kolonat) e tabelës, ku janë klasat dhe përmbi to është emërtimi **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e matematikës (RNL) (kujto planifikimet dymujore)**, puno sipas kësaj ecurie, merrni rezultatet e hapit të dytë-rezultatet e planeve dhe programeve ekzistuese të lëndës së caktuar të klasës së caktuar që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) dhe merrni rezultatet e hapit të tretë - rezultatet pritshme të shtuara dhe vendosni në klasën-klasat e caktuara përmbi të cilave është emërtimi **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e matematikës**

(RNL). Këto rezultate duhet të jenë versioni final i dy hapave, të hapit të dytë dhe të hapit të tretë. **Rezultatet e këtyre dy hapave** (hapit të parë dhe hapit të dytë) duhet lexuar me kujdes dhe të përpunuara **të vendosen në klasën–klasat** që kanë emërtimin **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e Matematikës (RNL) (kujto planifikimet dymujore).**

Shih shigjetat në tabelën më sipër.

Kjo tabelë është e vlefshme për një shkallë, do të thotë për sa klasë që ka shkalla – për një gjeneratë.

- Atëherë mësime dhënësi duhet të vendosë për një gjeneratë (për nxënësit e njëjtë) se cilat rezultate duhet t'i arrijnë për secilën klasë, p.sh. çka për klasën parafillore, çka për klasën e parë dhe çka për klasën e dytë.
- Procedurë e njëjtë duhet të ndiqet për të gjitha shkallët, si për shkallën 1, si për shkallën 2,... apo shkallën 6.
- Përjashtim ka klasa e parë, sepse nxënësit në klasën parë mund të mos kenë shkuar në klasën parafillore, andaj rezultatet për klasën e parë ndoshta prapë do të jenë start i të gjithë nxënësve, si për ata që kanë qenë në klasën parafillore, si për ata që nuk kanë qenë në këtë klasë. Mësuesit duhet të jenë të kujdesëm kur të shkruajnë rezultatet në kolonën me emërtim **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL)**, sepse në klasë të parë ka nxënës me përgatitje të ndryshme.

Ky paragraf është i vlefshëm për të gjitha shkallët dhe u dedikohet kolonave me emërtim **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL) (kujto planifikimet dymujore).**

Plani mësimor (këtë shembull mund ta ndiqni edhe për shkallët tjera kurrikulare)

Shkolla e mesme e ulët (SNKA 2)				
Fusha kurrikulare	Shk. 3			
	Kl. VI	Kl. VII	Gjithsej orë	
	Nr. i orëve	Nr. i orëve	Gj. orë	%
Matematika				17.86

Planifikimi për shkallë (shkalla e pestë)

Klasa e dhjetë					Klasa e njëmbëdhjetë			
Fushat	RNSH-kompetencë	Konceptet	RNF	Tema mësimore	RNSH-kompetencë	Konceptet	RNF.. ...	Tema mësimore
Gj. komunikimi								
Artet								
Matematikë								
Shoqëria dhe mjedisi								
Shkenca të natyrës								
Shëndeti mirëqenia								
Jeta dhe puna								

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës MATEMATIKA

Viti shkollor 2013-2014
KLASA I.

Fusha e kurrikulës	Konceptet e fushës kurrikulare (marrë nga KB)	Rezultatet e fushës së Kurrikulës Bërthamë (KB) marrë nga KB	Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilin fushë kurrikulare	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve				Rezultatet e Kompetencave (Rezultatet e te nxënësit për shkallë)
				Shtator-tetor	Nëntor - dhjetor	Janar-shkurt	Mars-prill	
Matematika	Numri dhe algjebra; Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria; Përpunimi i shënimeve dhe probabiliteti; Përdorimi dhe zbatimi i matematikës.	1. Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë. 2. Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. 3. Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për	Aritmetika dhe algjebra Gjeometria dhe matjet Përpunimi i të dhënave Përdorimi i TIK-ut	Aritmetika dhe algjebra (pozicionet, bashkësitë, kuptimi dhe paraqitja me diagrame dhe tabela . kuptimi i numrave dhe shkrimi i numërorëve	Aritmetika dhe algjebra (shenjat, kuptimi i numrave dhe shkrimi i numërorëve prej 5 deri 10, veprimet me numrat- mbledhja dhe zbritja,	Aritmetika dhe algjebra (kuptimi i numrave dhe shkrimi i numërorëve prej 11 deri 20, monedhat, veprimet me numrat- mbledhja dhe zbritja, kuptimi për simetrimin dhe	Aritmetika dhe algjebra (veprimet me numrat dhe paraqitja në boshtin numerik, krahasimi). Gjeometria dhe matjet (matja e gjatësive dhe krahasimi i	I.3. II.1 II.2 II.3. II.4 III.1. III.3. III.4. III.6. III.7 IV.5. V.5. VI.1.

	<p>përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore.</p> <p>4. Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve.</p> <p>5. Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p> <p>6. Identifikon vetitë e formave dhe objekteve të ndryshme dhe i klasifikon ato sipas këtyre vetive; krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme.</p> <p>7. Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashëshkollor.</p> <p>8. Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.</p>		<p>prej 0 deri 4)</p> <p>Gjeometria dhe matjet (orientimi, vijat)</p> <p>Përdorimi i TIK-ut (gishtat, shkopinjë, numërorja, plastelinë, petëzat,</p> <p>Aktivitet në kopsht me hapa).</p>	<p>krahasimi)</p> <p>Gjeometria dhe matjet (trupat dhe figurat gjeometrike.)</p>	<p>drejtëzën e simetrisë),</p> <p>Gjeometria dhe matjet (trupat dhe figurat gjeometrike, njohja me matjet).</p>	<p>gjatësive dhe krahasimi i rezultateve gjatë matjeve).</p>	<p>rezultateve gjatë matjeve).</p> <p>Përpunimi i të dhënave (leximi dhe paraqitja e të dhënave me tabela, figura dhe shtylla).</p>	
--	---	--	--	--	--	--	---	--

fusha kurrikulës	PLANI VJETOR KLASA VI					Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkollë)	
	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve	Shtator-tetor	Nëntor -dhjetor	Janar- shkurt	Mars-prill		Maj –qershor
<p>Konceptet e fushës kurrikulare (marrë nga KB)</p> <ul style="list-style-type: none"> Numri dhe algjebra Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria Përpunimi i shënimeve dhe probabilitetit Përdorimi dhe zbatimi i matematikës 	<p>Temat mësimore që trajtohen gjatë vitit mësimor për secilin fushë kurrikulare</p> <p>3.Numrat (natyrorë, thyesor dhe dhjetorë)</p> <p>4.Bashkësitë (veprimet me bashkësi dhe pasqyrimi)</p> <p>5.Gjeometria dhe matjet (Pika, drejtëza, rrafshi, këndi, Shumëkëndës hat-perimetri, katrori dhe drejtkëndëshi -sipërfaqja, kubi dhe kuboidi-vëllimi. Matja e kohës.)</p> <p>6. Zgjidhja e problemeve matematike (matematikë, mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme. Identifikon vetitë e formave dhe objekteve të ndryshme dhe i klasifikon ato sipas vetive; krijon modele të thjeshta, duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme.</p>	<p>Shtator-tetor</p> <p>1.1 Numrat natyrorë (veprime me nr. natyrorë, plotpjesueshmëria)</p> <p>4. Zgjidhja e problemeve matematike</p> <p>4.1 Zgjidhja e problemeve me numra natyrorë (ekuacione, inekuacione)</p> <p>3.Gjeometria dhe matjet</p> <p>3.1 Kuptime themelore gjeometrike, pozitat reciproke të tyre. Matja e kohës.</p>	<p>Nëntor -dhjetor</p> <p>1. Numrat</p> <p>1.2 Thyesat dhe numrat dhjetorë (Kuptimi, llojet e thyesave, thyesat barabarta, zgjerimi, thjeshtimi, krahasimi si dhe kuptimi, rumbullakimi i numrave dhjetorë, paraqitja e tyre në numerike)</p> <p>1. Numrat</p> <p>1.3 Veprime me thyesa dhjetorë (+, -, *, /, radha e veprimeve).</p>	<p>Janar- shkurt</p> <p>4. Shprehjet shkronjore</p> <p>4.2 Zgjidhja e problemeve me numra thyesorë dhe dhjetorë (ekuacione, inekuacione)</p> <p>3. Gjeometria dhe matjet</p> <p>3.2 Këndet (kuptimi i këndit, llojet e këndeve, matja (njësi të matëse: grada, minuta, sekonda këndore) dhe vizatimi (konstruktivi dhe këndmatës dhe kompas, simetria))</p> <p>3.3 Shuma dhe ndryshimi i këndeve</p>	<p>Mars-prill</p> <p>2. Bashkësitë</p> <p>2.1 Kuptimi i bashkësisë dhe nënbashkësisë</p> <p>2.2 Disa veprime me bashkësi (U, \cap, \cup, Δ, \times)</p> <p>2.3 Pasqyrimi i lidhjeve bashkësie (Koordinatat e pikave në rrafsh, paraqitja e tyre në rrafshin koordinativ)</p> <p>3. Gjeometria dhe matjet</p> <p>3.4 Shumëkëndëshat (përkufizimi, këndet, diagonalat e shumëkëndëshit, rregullt, katërkëndëshat, konstruktivi i disa ndëshave të shumëve të rregullt, katërkëndëshat, llojet e tyre)</p> <p>3.5 Matja e gjatësive perimetri (raporti ndërmjet matëse standarde të gjatësive)</p> <p>3.6 Matja e sipërfaqeve dhe vëllimeve (raporti ndërmjet njësive matëse të sipërfaqeve, syprina e drejtkëndëshe dhe katrore).</p>	<p>Maj –qershor</p> <p>3.7 Rrethi (kuptimi dhe vizatimi)</p> <p>3.8 Kubi dhe kuboidi (Ndërtimi i kubit dhe kuboidit, syprina e sipërfaqes kubike dhe kubike)</p> <p>3.9 Matja e madhësisë së një trupi (vëllimi i tij), (raporti ndërmjet njësive kubike, dhe kuboidit)</p> <p>5. Statistika dhe probabiliteti</p> <p>5.1 Të dhënat statistikore (grumbullimi, klasifikimi dhe paraqitja e tyre, tendencat qendrore (e mesjza aritmetike, moda, mediana))</p> <p>5.2 Hedhja e monedhës ose e zarit (shënimi i gjatësive me thyesa)</p>	<p>1.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.</p> <p>1.6 Shpjegon qartë dhe saktë me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.</p> <p>2.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor, etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale numerike eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.</p> <p>3.1 Kërkon dhe përzgjedh të dhëna në burime të ndryshme (si: libra, revista, doracak, fjalor, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>3.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.</p> <p>4.8 Merr pjesë si anëtar i një jurie (në nivel klase apo shkollë) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi sportiv, shkencor, artistik etj., duke u bazuar në kriteret e caktuara.</p> <p>6.1 Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë, etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që s'i përfillojnë ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.</p>
Matematikë							

Planifikimi vjetor i temave mësimore për të gjitha fushat e kurrikulës

Viti shkollor 2013-2014

Klasa: 10. AP



Fusha e kurrikulës	Konceptet e fushës kurrikulare (marrë nga KB)	Rezultatet e fushës së Kurrikulës Bërthamë (KB) marrë nga KB	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve				Maj qershor	Rezultatet e Kompetencave (Rezultatet e nxënësve për shkallë)
			Shtator-tetor	Nëntor - dhjetor	Janar-shkurt	Mars-prill		
MATHEMATIKA	Numrat real Format Matjet Algjebra Statistika Gjeometria Trigonometria Gjeometria Analitike Analiza. Kombinatorika	<p>1. Zgjidhja e problemeve. Përzgjedh strategji të përshtatshme nga algjebra dhe nga gjeometria për të zgjidhur problem që zbatohen në situata të përditshme jetësore.</p> <p>2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike. Përzgjedh strategji të përshtatshme nga algjebra dhe nga gjeometria për të zgjidhur problem që zbatohen në situata të përditshme jetësore.</p> <p>Vërteton teorema duke përdorur koncepte matematike dhe jo matematike.</p> <p>3. Komunikimi në/përmes matematikës Përdor tipa të ndryshëm të diskutimit matematik ("forma të të shprehurit") duke përdorur gjuhën natyrore dhe matematikore (p.sh., grafikët, diagramet), formulon hipoteza, përkufizon, arsyeton, nxjerr konkludime relevante.</p> <p>4. Lidhja matematike Bën lidhjen mes numrave dhe koncepteve algjebrike, gjeometrike dhe trigonometrike në situata praktike.</p>	<p>Aritmetika dhe algjebra (Numrat, Logjika Matematike Barazimet Funksionet Lineare dhe Kuadratike)</p> <p>Gjeometria (Matjet, Figurat dhe Trupat Gjeometrik)</p> <p>Statistika dhe probabiliteti</p>	<p>Algjebra</p> <p>Numrat, Logjika matematike dhe bashkësitë, relacionet, pasqyrimet</p> <p>Algjebra</p> <p>Fuqizimi dhe rrënjëzimi.</p> <p>Polinome</p> <p>Kombinatorika.</p>	<p>Algjebra- Ekuacionet dhe funksionet lineare dhe kuadratike.</p>	<p>Algjebra Gjeometria</p> <p>Funksionet trigon. në trekëndëshi në kënddrejtë</p> <p>Matjet në gjeometri.</p>	<p>Statistika</p> <p>Elementet e statistikës</p> <p>Grupimi i të dhënave.</p> <p>Teoria e gjës.</p>	<p>I.4. Përdor...</p> <p>I.8. Prezanton...</p> <p>II.1. Në forma...</p> <p>II.3. Harton...</p> <p>II.4. Modelon...</p> <p>II.5. Llogarit...</p> <p>II.6. Gjykon...</p> <p>III.1. Demonstron...</p> <p>III.2. Në menyre...</p> <p>III.3 Parashtron...</p> <p>III.4 Zgjidh...</p> <p>III.5 Pergatit...</p> <p>III.6 Në ...</p> <p>III.7 Kërkon...</p> <p>III.8 Paraqet...</p> <p>III.9 Në menyre...</p> <p>IV.3. Hulumton...</p> <p>IV.7 Harton...</p> <p>IV.9 Merr...</p>

Planifikimi dymujor i njësive mësimore për temat mësimore



Fusha:	MATEMATIKA
Klasa:	X (dhjetë) DREJTIMI NAYROR
Muajt:	SHTATOR – TETOR
Tema mësimore:	Logjika matematike, Bashkësitë, Relacioni, Pasqyrimi, Veprimet binare, Numrat.
Rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen përmes temës:	<p>1. Të mendoarit matematik</p> <p>Me zbatimin e saj në fushat jashtë matematikës, bën strukturimin e të menduarit matematik, duke komunikuar në mënyrë koherente dhe të qartë;</p> <p>2. (1.4). Përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të gjuhës;</p> <p>3.(2.3). Krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme;</p> <p>4.(2.6). Gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë;</p> <p>5.(3.4). Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme;</p> <p>6.(3.5). Përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale;</p> <p>7.(3.6). Në mënyrë të pavarur dhe efektive shfrytëzon teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit;</p> <p>8.(3.7). Kërkon dhe shfrytëzon në mënyrë të duhur këshilla dhe informata për kapërcimin e vështirësive në të nxënë.</p> <p>9.(3.8). Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar duke dhënë mendime;</p> <p>10.(3.9). Në mënyrë të pavarur shfrytëzon udhëzimet e dhëna në ndonjë burim të informatave për të kryer një veprim, aktivitet.</p>
Rezultatet e fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës:	<p>1. Zgjidhja e problemeve</p> <p>Përzgjedh strategji të përshtatshme nga algebra dhe nga gjeometria për të zgjidhur problem që zbatohen në situata të përditshme jetësore.</p> <p>2. Komunikimi në përmes matematikës</p> <p>Përdor tipa të ndryshëm të diskutimit matematik (“forma të të shprehurit”) duke përdorur gjuhën natyrore dhe matematikore (p.sh., grafikët, diagramet), formulon hipoteza, përkufizon, arsyeton, nxjerr konkludime relevante.</p> <p>3. Lidhja matematike</p> <p>Bën lidhjen mes numrave dhe koncepteve algjebrike, gjeometrike në situata praktike.</p> <p>4. Përfaqësimet matematike</p> <p>Ndërton forma ekuivalente të përfaqësimit të modeleve dhe koncepteve për të interpretuar fenomenet sociale, natyrore dhe matematikore.</p> <p>5. Modelimi matematik</p> <p>Ndërton modele të reja dhe përdor metoda algoritmike matematike (p.sh., për të analizuar të dhënat, për të kryer matje të ndryshme etj.).</p> <p>6. Përdorimi i TIK-ut në përmes matematikë</p> <p>Përdor programe softuerike të përshtatshme (p.sh., tabelat në Excel) për njehsime të ndryshme në matematikë; identifikon përparësitë dhe kufizimet e përdorimit të teknologjisë moderne dhe TIK në matematikë.</p>
Çështjet ndërkurrikulare:	<p>1. Zhvillim personal dhe shkathësi për jetë, punë në ekip, zgjidhje të problemeve, vendimmarrje, planifikim të buxhetit personal.</p> <p>2. Zhvillim i qëndrueshëm, vetëdije ekonomike, shkathësi gjuhësore dhe të komunikimit, mësimin elektronik (TIK), krijim të modeleve virtuale matematikore.</p> <p>3. Grumbullimi i të dhënave dhe paraqitja në grafikone.</p>

Lëndë mësimore	Rezultatet e të nxënimit të lëndës	Njësitë mësimore	Koha nevojshme	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet
MATEMATIKA	<p>Përshkruan domethënien e termave në kontekst.</p> <p>Përdor shenjën e dollarit, formulat e përshtatshme për bashkësitë, pasqyrimet, gjykimet.</p> <p>Zbaton veprimet themelore me numrat realë dhe komplekse.</p> <p>Analizon zgjedhshmërinë e problemit në saje të të dhënave që disponon.</p> <p>Përzgjedh strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve.</p> <p>Përdor komunikimin përmes matematikës.</p> <p>Zbaton programe të përshtatshme me anë të teknologjisë informative.</p>	<p>Logjika Matematike:</p> <ol style="list-style-type: none"> Gjykimet Veprimet me gjykime Arsyetimet logjike Formulat e gjykimeve. Kuantifikatorët <p>Bashkësitë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Bashkësitë Veprimet me bashkësi Prodhimi kartezian i bashkësive. <p>TESTIM</p> <p>Relacionet:</p> <ol style="list-style-type: none"> Relacioni dhe vetit e tyre Relacioni i ekuivalencës Relacioni i renditjes <p>Pasqyrimet:</p> <ol style="list-style-type: none"> Llojet e pasqyimeve Pasqyrimi invers Prodhimi i pasqyimeve <p>Veprimet binare</p> <ol style="list-style-type: none"> <u>Kuptimi i veprimit binar</u> <u>Ligjet e veprimeve binare</u> <p>Aksiomat dhe teoremat.</p> <p>Numrat :</p> <ol style="list-style-type: none"> Numrat natyrorë. Numrat e plotë. Numrat racionalë Numrat irracionalë Numrat realë <p>TESTIM</p>	<p>8 orë</p> <p>5 orë</p> <p>2 orë</p> <p>4 orë</p> <p>6 orë</p> <p>4 orë</p> <p>2 orë</p> <p>2 orë</p>	<p>Metoda ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.</p> <p>Përdor teknika të kombinuara dhe shumëllojta.</p> <p>Demonstrimi dhe mënyra e ekzekutimit të operacioneve.</p> <p>Puna individuale dhe grupore.</p> <p>Stuhi mendimesh, Bashkëbisedim, Demonstrim individual, Demonstrimi grupor.</p>	<p>Vlerësimi me pergjigjeve gojë.</p> <p>Vlerësimi në ndihmëses grup.</p> <p>Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.</p> <p>Testet në fund të kategorisë së përbajtjes.</p> <p>Vlerësimi i bazuar në kriter në</p> <p>Vlerësimi proces</p> <p>Vlerësimi formues</p> <p>Vlerësimi diagnostikues</p> <p>Vlerësimi përmbledhës</p>	<p>Tekste,</p> <p>Matematika për klasën e dhjete (X).</p> <p>Përmbledhje detyrash të matematikës të klasës dhjete (X).</p> <p>Interneti</p> <p>Sllajde</p>
Fusha:				MATEMATIKA		

Klasa:	X (dhjetë) DREJTIMI SHOQËROR-GJUHËSOR
Muajt:	SHTATOR – TETOR
Tema mësimore:	Logjika matematike, Bashkësitë, Relacioni, Pasqyrimi, Veprimet binare, Numrat.
Rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen përmes temës:	
1. Të menduarit matematik: Me zbatimin e saj në fushat jashtë matematikës bën strukturimin e të menduarit matematik, duke komunikuar në mënyrë koherente dhe të qartë.	
2. (1.4). Përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të gjuhës;	
3.(2.3). Krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme;	
4.(2.6). Gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë;	
5.(3.4). Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme;	
6.(3.5). Përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale;	
7.(3.6). Në mënyrë të pavarur dhe efektive shfrytëzon teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit;	
8.(3.7). Kërkon dhe shfrytëzon në mënyrë të duhur këshilla dhe informata për kapërcimin e vështirësive në të nxënë;	
9.(3.8).Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar duke dhënë mendime.	
10.(3.9). Në mënyrë të pavarur shfrytëzon udhëzimet e dhëna në ndonjë burim të informatave për të kryer një veprim, aktivitet.	
Rezultatet e fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës:	
1. Zgjidhja e problemeve	
Përzgjedh strategji të përshtatshme nga algebra dhe nga gjeometria për të zgjidhur problem që zbatohen në situata të përditshme jetësor.	
2. Komunikimi në/përmes matematikës	
Përdor tipa të ndryshëm të diskutimit matematik (“forma të të shprehurit”) duke përdorur gjuhën natyrore dhe matematikore (p.sh., grafikët, diagramet), formulon hipoteza, përkufizon, arsyeon, nxjerr konkludime relevante.	
3. Lidhja matematike	
Bën lidhjen mes numrave dhe koncepteve algjebrike, gjeometrike në situata praktike.	
4. Përfaqësimet matematike	
Ndërton forma ekuivalente të përfaqësimit të modeleve dhe koncepteve për të interpretuar fenomenet sociale, natyrore dhe matematikore.	
5. Modelimi matematik	
Ndërton modele të reja dhe përdor metoda algoritmike matematike (p.sh., për të analizuar të dhënat, për të kryer matje të ndryshme etj.).	
6. Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë	
Përdor programe softuerike të përshtatshme (p.sh., tabelat në Excel) për njehsime të ndryshme në matematikë; identifikon përparësitë dhe kufizimet e përdorimit të teknologjisë moderne dhe TIK në matematikë.	
Çëshjet ndërkurrikulare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillim personal dhe shkathtësi për jetë, puna në ekip, zgjidhje të problemeve, vendimmarrje, planifikim të buxhetit personal. 2. Zhvillim i qëndrueshëm, vetëdije ekonomike, shkathtësi gjuhësore dhe të komunikimit, mësimin elektronik (TIK), krijimi i modeleve virtuale matematikore. 3. Grumbullimi i të dhënave dhe paraqitja në grafikone.


Lëndët mësimore	Rezultatet e të nxënimit të lëndës	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet
M A T E M A T I K A	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan domethënien e termave në kontekst. • Përdor shenjën e dollarit, formulat e përshtatshme për bashkësitë, pasqyrimet, gjykimet. • Zbaton veprimet themelore me numrat realë dhe komplekse. • Analizon zgjedhshmërinë e problemit në saje të të dhënave që disponon. • Përzgjedh strategji të e përshtatshme për zgjidhjen e problemeve. • Përdor komunikimin përmes matematikës. • Zbaton programe të përshtatshme me anë të teknologjisë. 	<p>Njësitë mësimore</p> <p>Logjika Matematike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjykimet 2. Veprimet me gjykime 3. Arsyetimet logjike 4. Formulatat e gjykimeve.. 5. Kuantifikatorët <p>Bashkësitë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkësitë 2. Veprimet me bashkësi 3. Prodhimi kartezian i bashkësive. <p>TESTIM</p> <p>Relacionet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Relacioni dhe vetit e tyre 2. Relacioni i ekuivalencës 3. Relacioni i renditjes <p>Pasqyrimet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Llojet e pasqyimeve 2. Pasqyrimi invers 3. Prodhimi i pasqyimeve 	<p>6 orë</p> <p>4 orë</p> <p>2 orë</p> <p>3 orë</p> <p>4 orë</p>	<p>Metoda ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.</p> <p>Përdor teknika të kombinuara dhe të shumëllojta.</p> <p>Demonstrimi dhe mënyra e ekzekutimit të operacioneve.</p> <p>Puna individuale dhe grupore.</p> <p>Stuhi mendimesh, Bashkëbisedim, Demonstrimi individual, Demonstrimi grupor.</p>	<p>Vlerësimi i përgjigjeve me gojë.</p> <p>Vlerësimi i ndihmesës në grup.</p> <p>Vlerësimi i detyrave të shpëtitshme.</p> <p>Testet në fund të kategorisë së përmbajtjes.</p> <p>Vlerësimi i bazuar në kriter.</p> <p>Vlerësimi në proces.</p> <p>Vlerësimi formues.</p> <p>Vlerësimi diagnostikues.</p> <p>Vlerësimi përmbledhës.</p>	<p>Tekste, Matematika për klasën e dhjetë (X).</p> <p>Përmbledhje detyrash të matematikës, të klasës së dhjetë (X).</p> <p>Internti, Sllajde.</p>

Planifikimi dymujor i punës mësimore

Fusha: MATEMATIKË

Klasa: VI

Muajt: Shtator-tetor

<p>REZULTATET E KOMPETENCAVE (RNSH)</p> <p>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Komunikues efektiv).</p> <p>1.2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.</p> <p>1.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe te saktë.</p> <p>2. Kompetenca e të menduarit (Mendimtar kreativ).</p> <p>2.4. Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, Shoqëror, shkencor. . . etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale dhe arsyeon përzgjedhjen e procedurave përkatëse.</p> <p>3. Kompetenca e të nxënit</p> <p>3.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.</p>	<p>REZULTATET E FUSHËS KURRIKULARE (RF)</p> <p>Matematikë</p> <p>3. Komunikimi në/përmes matematikës Përdor terminologjinë matematikore (p. sh. . dhjetor, thyese, përqindje, mode, mediane etj.) dhe simbolet algjebrike dhe gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.</p> <p>4. Lidhjet në matematikë, Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme.</p> <p>8. Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë. Përdor kalkulatorët e avancuar për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara matematikore.</p>	<p>Synohen të arrihen përmes temave</p> <p style="text-align: center;"></p>	<p>Temat mësimore</p> <p>1. Numrat natyrorë</p> <p>2. Gjeom. dhe matjet</p>
--	--	--	--

Korrelacioni me fushat kurrikulare:

Gjuhët dhe komunikimi - Të flitet dhe shkruhet gjuha e njësuar shqipe, mund të përdoren teknika që i ndihmojnë kësaj, p.sh Pesëvargëshi.

Shkencat e natyrës dhe shoqërore - Të shtjellohen faktet nga fizika dhe nga historia te tema (njësia) "Matja e kohës".

Rezultatet e të nxënit të lëndës	Njësitë mësimore	Koha nevojshme (43 orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Lexon dhe shkruan numrat natyrorë; ✓ Identifikon vendvlerën e shifrës; ✓ Krahason numrat natyrorë; ✓ Rrumbullakon numrat natyrorë duke i paraqitur në boshtin numerikë. 	<p>3. Numrat natyrorë</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Leximi dhe shkrimi, ✓ Krahasimi, ✓ Rrumbullakimi (Paraqitja në boshtin numerikë). 	5 orë mësimore	<p>Metodat Bashkëbisedues e, demonstruese</p> <p>Teknikat -që zhvillojnë të menduarit kritik dhe që kanë nxënësin në qendër të aktivitetit, si: Stuhi mendimesh, Klasteri, Ditari dypjesësh,</p>	<p>VpN</p> <p>Instrumenti: Lista e kontrollit.</p>	-Teksti shkollor aktual (Matematika për kl. 6 dhe Përmbledhje detyrash nga matematika kl. 6). Burime tjera që ceken gjatë planifikimeve të orëve mësimore.
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Llogarit shumën, ndryshimin, prodhimin, herësin e këtyre numrave natyrorë (me mend, me dorë si dhe në raste të veçanta me kalkulatorë); ✓ Zbaton radhën e veprimeve matematikore në detyra me numra natyrorë; ✓ Zgjidh probleme me fjalë nga jeta e përditshme. 	<p>1.1 Veprimet me numra natyrorë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Mbledhja dhe zbritja numrave natyrorë. ✓ Shumëzimi i numrave natyrorë (shumëfishat). ✓ Pjesëtimi i numrave natyrorë (pa mbetje dhe me mbetje). ✓ Radha e veprimeve matematikore. 	17 orë mësimore	<p>Metodat Bashkëbisedues e, demonstruese</p> <p>Teknikat -që zhvillojnë të menduarit kritik dhe që kanë nxënësin në qendër të aktivitetit, si: Stuhi mendimesh, Ditari dypjesësh, Pesëvargësh.</p>	<p>VpN</p> <p>Instrumenti: Lista e kontrollit.</p> <p>Vlerësim sumativ: Detyra kontrolluese</p>	-Teksti shkollor aktual (Matematika për kl. 6 dhe Përmbledhje detyrash nga matematika kl. 6). Detyra të përpiluara nga arsimtari Burime tjera që ceken gjatë planifikimeve të orëve mësimore.
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Kupton plotpjestueshmërinë si pjesëtim pa mbetje duke e treguar këtë përmes shembujve; ✓ Zbaton rregullat për caktimin e numrave që janë të plotpjestueshëm me 2, me 3, etj; ✓ Dallon numrat e thjeshtë dhe numrat e përbërë, zbërthen numrat e përbërë në faktorë të 	<p>1.2 Plotpjestueshmëria.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Plotpjestueshmëria me 2, 4, 5, 10, 3, 9 (rregullat e plotpjestueshmërisë). ✓ Numrat e thjeshtë dhe të përbërë. ✓ Pjesëtuesi 	15 orë mësimore	<p>Metodat Bashkëbisedues e, demonstruese</p> <p>Teknikat -që zhvillojnë të menduarit kritik dhe që kanë nxënësin në qendër të aktivitetit, si: Stuhi mendimesh, Ditari</p>	<p>VpN</p> <p>Instrumenti: Lista e kontrollit,</p> <p>Vlerësim sumativ: Test përmbledhës për numrat natyrorë</p>	-Teksti shkollor aktual (Matematika për kl. 6 dhe Përmbledhje detyrash nga matematika kl. 6). Detyra të përpiluara nga arsimtari.


<p>thjeshtë; ✓ Cakton Pmmp dhe Shmvp e dy apo më shumë numrave natyrorë; ✓ Zgjidh probleme me Shmvp dhe Pmmp.</p>	<p>më i madh i përbashkët i nr. natyrorë Pmmp. ✓ Shumëfishi më i vogël i përbashkët i nr. natyrorë Shmvp. ✓ Zgjidhja e problemeve lidhur me Pmmp dhe Shmvp.</p>		<p>dypjesësh, Copëzat e përziera, Lapsat në mes.</p>		<p>Burime tjera që ceken gjatë planifikimeve të orëve mësimore.</p>
<p>✓ Përdor saktë njësitë matëse për matje të kohës; ✓ Përafro kohën në orën, ditën, javën, ... më të afërt; ✓ Zgjidh probleme që kanë të bëjnë me matje të kohës.</p>	<p>4. Matja e kohës ✓ Ora, minuta, sekonda ✓ Dita, java, muaji ✓ Viti, dekada, epoka, ✓ Shekulli, mileniumi.</p>	<p>5 orë mësimore</p>	<p>Metodat Bashkëbisedues e, demonstruese Teknikat -që zhvillojnë të menduarit kritik dhe që kanë nxënësin në qendër të aktivitetit, si: Stuhi mendimesh, Copëzat e përziera, Lapsat në mes</p>	<p>VpN Instrumenti: Lista e kontrollit.</p>	<p>Kalendari vjetor, Detyra të përgatitura nga arsimtari. Burime tjera që ceken gjatë planifikimeve të orëve mësimore.</p>

Planifikimi dymujor i punës mësimore

Fusha: MATEMATIKË

Klasa: VI

Muajt: Nëntor -dhjetor

REZULTATET E KOMPETENCAVE (RNSH)	REZULTATET E FUSHËS KURRIKULARE (RF)		Tema mësimore
<p>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Komunikues efektiv)</p> <p>1.2. Dëgjon në mënyre aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.</p> <p>1.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.</p> <p>2. Kompetenca e të menduarit (Mendimtar kreativ)</p> <p>2.4. Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor. . . etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.</p> <p>3. Kompetenca e të nxënës</p> <p>3.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.</p>	<p>Matematikë</p> <p>3. Komunikimi në/përmes matematikë/s Përdor terminologjinë matematikore (p. sh. . dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algjebrike dhe gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.</p> <p>4. Lidhjet në matematikë Integron/Lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyre që të zgjidhë probleme të ndryshme</p> <p>8. Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë Përdor kalkulatorët e avancuar për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara matematikore.</p>	<p>Synohen të arrihen përmes temave</p> <p style="text-align: center;"></p>	<p>1. Numrat thyesorë</p> <p>2. Numrat</p> <p>dhjetorë</p>

Korrelacioni me fushat kurrikulare:

- Gjuhët dhe komunikimi - (Të flitet dhe shkruhet gjuha e njësuar shqipe).
- Shkencat e natyrës dhe shoqërore - (Të shtjellohen faktet nga fizika dhe në përgjithësi nga përditshmëria).

Rezultatet e të nxënit të lëndës	Njësitë mësimore	Koha nevojshme (35 orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet
